

2024

**Raporti Vjetor i
Qëndrushmërisë**



PËRMBAJTJA

RRETH RAPORTIT	1
RRETH NESH	2
MESAZHI NGA KRYESHEFI EKZEKUTIV (CEO)	3
KUSH ËSHTË TITAN GROUP	4
Një Trashëgimi e Inovacionit dhe e Rritjes së Qëndrueshme	4
Vlerat Tona	5
PRODUKTET DHE ZINXHIRI I VLERËS	6
Klientët Tanë	6
POLITIKAT DHE VLERAT E MENAXHMENTIT	9
Shpërndarja e Vlerës Për të Gjithë	10
VLERËSIMI I MATERIALITETIT DHE ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT	11

SHQYRTIMI I PERFORMANCËS NË FUSHËN E ESG-SË	14
Fusha në Fokus: Dekarbonizimi dhe digjitalizimi	15
Fusha në Fokus: Mjedisi i punës që mbështet ritjen	17
Fusha në Fokus: Ndikimi pozitiv në nivel lokal	23
Fusha në Fokus: Furnizim i përgjegjshëm	29
QEVERISJA E MIRË, TRANSPARENCA DHE ETIKA E BIZNESIT	31
RISHIKIMI I PERFORMANCËS FINANCIARE	33
DEKLARATAT E PERFORMANCËS NË FUSHËN E ESG-SË	35
FJALORTHË	63

RRETH RAPORTIT

Mirë se vini në Raportin Vjetor të Qëndrueshmërisë 2024 të TITAN SHARRCEM. Si një lider në industrinë e çimentos, ne jemi të përkushtuar për të integruar qëndrueshmërinë në operacionet tona thelbësore, duke garantuar transparencë, përgjegjshmëri dhe një ndikim afatgjatë pozitiv.

Ky raport ofron një pasqyrë të performancës sonë në fushën e qëndrueshmërisë për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2024, duke theksuar nismat kyçe në ruajtjen e mjedisit, ndikimin social dhe qeverisjen korporative. Nga reduktimi i ndotjeve të karbonit deri te mbështetja për zhvillimet të komunitetit, TITAN SHARRCEM – një degë e Titan S.A. – vazhdon të kontribuojë në një të ardhme më të qëndrueshme për Kosovën.

Sharrcem operon një fabrikë çimentoje në Han të Elezit, së bashku me tre gurore në afërsi dhe degë që menaxhojnë terminale në Lipjan, Duhël dhe Klinë. Raporti është në përputhje me udhëzimet për qëndrueshmëri të ofruara nga TITAN, Kompakti Global të OKB-së, Shoqatës Globale të Çimentos dhe Betonit (GCCA), si dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së 2030 (SDGs).

Gjithashtu, raporti pasqyron praktikën më të mira të raportimit të kompanisë mëmë, duke ndjekur kornizën që TITAN ka përcaktuar për përfshirjen e udhëzimeve nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD) dhe Këshilli Ndërkombëtar për Raportimin e Integruar (IIRC). Raporti është përgatitur me referencë ndaj standardeve të Iniciativës Globale për Raportim (GRI) dhe atyre të Bordit për Standardet e Raportimit të Qëndrueshmërisë (SASB), veçanërisht për lidhjen me Treguesit Kyç të Performancës (KPIs), të përfshirë në seksionin e Performancës ESG. Për më tepër, treguesit e përzgjedhur, të shënuar në listën e KPI-ve ESG si pjesë integrale e këtij raporti, janë në përputhje me standardet e BE-së për ESRS.

Shënim

Përderisa Grupi TITAN merr pjesë në Kompaktin Global të OKB-së, mbështetja e Sharrcem për parimet e veta është plotësisht e konsoliduar sipas angazhimit të kompanisë mëmë.

Sqarimi i Përgjegjësisë:

Që nga 5 maji 2025, Titan Cement International S.A., kompania mëmë e Grupit, ndryshoi emrin e saj në Titan SA. Ndryshimi i emrit pasqyron vizionin më të gjerë dhe largpamës të Kompanisë, në përputhje me fokusin e saj strategjik në qëndrueshmëri dhe ofrimin e produkteve dhe zgjidhjeve me vlerë të shtuar për një të ardhme të qëndrueshme (ne i referohemi TITAN SA si Grupi TITAN ose thjesht TITAN në këtë Raport). Për më tepër, domeni i faqes së internetit të Kompanisë është përditësuar në www.titanmaterials.com.



TITAN SHARRCEM është e vetmja fabrikë çimentoje në Kosovë, një simbol i qëndrueshmërisë dhe përparimit.

Që nga viti 2010, nën udhëheqjen e TITAN Group, një aktor i rëndësishëm në sektorin ndërkombëtar të materialeve të ndërtimit dhe infrastrukturës, TITAN SHARRCEM ka promovuar një vizion shërbimi ndaj shoqërisë të ndërthurur me rritje të qëndrueshme, gjithmonë të udhëhequr nga parimet e përgjegjësisë dhe integritetit. Me një trashëgimi që daton që nga themelimi i tij në vitin 1936, TITAN SHARRCEM është zhvilluar nga fillimet modeste në një shembull të inovacionit dhe udhëheqjes brenda industrisë. Me seli në qytetin kufitar të Hanit të Elezit dhe të mbështetur nga zyra e saj në Prishtinë, kompania jo vetëm që lulëzon si një shtyllë e komunitetit lokal, por gjithashtu synon të përmbushë nevojat më të gjera të shoqërisë.

Në zemër të operacioneve të TITAN SHARRCEM qëndron përkushtimi ndaj ekselencës në prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e çimentos dhe materialeve të lidhura. Duke shfrytëzuar burimet nga gurthyesit në Dimcë dhe Seqishtë, si dhe duke integruar materiale të tjera të papërpunuara nga industri të tjera të Kosovës, TITAN SHARRCEM synon të ulë gjurmën mjedisore dhe të rrisë efikasitetin.

81,349,89 €

Shuma e parave për mallrat dhe shërbimet e paguara furnitorëve

8,085,810 €

Investimet totale (CAPEX) në vitin 2024

63,482 €

Taksa lokale (bashkiake dhe pronësore, të paguara)

3,468,105 €

Tatimet mbi të ardhurat e korporative

187,109 €

Kontributet pensionale të punonjësve, të paguara (5% e kontributit të paguar nga Sharrcem)

761,645 TONNES

Prodhimi total i çimentos



MESAZHI NGA KRYESHEFI EKZEKUTIV

Të nderuar palë të interesit,
partnerë dhe miq,

Kam nderin të ndaj me ju se viti 2024 ka qenë një vit me qëllime të ripërtërira dhe përparim të prekshëm për TITAN SHARRCEM, një vit ku kemi riformuluar identitetin tonë, kemi forcuar vlerat tona dhe kemi thelluar ndikimin tonë.

Kemi bërë hapa domethënës në rrugëtimin tonë drejt rritjes së qëndrueshme, inovacionit dhe përgjegjësisë. Gjatë vitit 2024, përpjekjet tona janë përkthyer në performancë të fuqishme dhe përparim domethënës në të gjitha dimensionet e qëndrueshmërisë. Ndërsa vazhdojmë të operojmë në një realitet gjithnjë në ndryshim, të shënuar nga sfida globale dhe mundësi lokale, fokusi ynë mbetet i qartë: të ndërtojmë një të ardhme më të qëndrueshme, për njerëzit tanë, për komunitetin dhe për planetin.

Ky vit shënoi një moment historik për organizatën tonë, pasi me krenari kemi përqafulur identitetin e ri korporativ të Grupit TITAN, një transformim që pasqyron qëllimin tonë të ripërtërirë dhe rolin tonë në zhvillim brenda shoqërisë. Bashkë me këtë ribërje të markës, kemi miratuar edhe

vlera të përditësuara korporative, të cilat tashmë udhëheqin çdo aspekt të vendimmarrjes dhe operacioneve tona.

Të udhëhequr nga këto vlera, kemi thelluar angazhimin tonë ndaj përfshirjes dhe zhvillimit të punonjësve. Përmes programeve të synuara të trajnimit dhe futjes së platformave digjitale të të mësuarit si Udemy, Coursera dhe PODD, kemi fuqizuar ekipet tona me aftësi të nevojshme për të ardhmen. Gjithashtu, kemi ruajtur fokusin tonë në diversitet, punësim lokal dhe në një kulturë pune gjithëpërfshirëse që u mundëson të gjithë individëve të rriten dhe të lulëzojnë.

Angazhimi ynë ndaj mjedisit mbetet në thelb të strategjisë sonë. Në vitin 2024, u ndjemë krenarë që rinovuam lejen tonë mjedisore, një dëshmi e qartë e transparencës dhe përpikmërisë së operacioneve tona. Po ashtu, përfunduar me sukses auditimin mjedisor sipas standardit ISO 14001:2015, pa asnjë mospërputhje, duke treguar fuqinë e sistemeve tona të menaxhimit mjedisor. Nëpërmjet iniciativave të angazhimit me komunitetin, kemi zgjeruar ndikimin tonë përtej fabrikës, duke nxitur vetëdijen mjedisore te gjeneratat e reja.

Kemi avancuar praktikat tona të ekonomisë qarkore, duke përdorur mbi 130,000 tonë lëndë të dyta si hiri fluturues, hiri fundërrues dhe hiri i piritit. Paralelisht, kemi vazhduar kalimin drejt karburanteve alternative, duke integruar burime energjie të nxjerra nga mbetjet në prodhimin e klinkerit. Këto përpjekje mbështesin objektivat tona për dekarbonizim si dhe qëllimet më të gjera mjedisore të Kosovës.

Besimi ynë në fuqinë transformuese të dijes dhe inovacionit u konkretizua edhe më tej me hapjen e Laboratorit të Betonit, një investim historik që përforcon kapacitetet në shkencën e materialeve dhe nxit bashkëpunimin me partnerët akademikë dhe të industrisë. Ky avancim u fuqizua edhe më shumë me përfaqësimin ekskluziv të aditiveve Chryso në tregun lokal, duke sjellë ekspertizë

ndërkombëtare dhe zgjidhje të karakterizuara nga performanca e lartë për të përmirësuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë në ndërtim. Ky përparim teknik u shoqërua nga Projekti “Frozen Music”, një iniciativë artistike dhe arkitekturore që e ripërfytyron çimenton jo vetëm si material ndërtimi, por si simbol të fuqishëm të kreativitetit, identitetit dhe qëndrueshmërisë.

Në kuadër të përkushtimit tonë për rritje dhe gjithëpërfshirje, TITAN SHARRCEM ka forcuar lidhjet me komunitetin përmes iniciativave të dedikuara për punësim. Duke prioritetizuar talentin lokal, kemi mirëpritur 7 punonjës të rinj nga Hani i Elezit gjatë vitit 2024, duke mbështetur njëkohësisht fuqinë punëtore dhe ekonominë vendore.

Gjithashtu, kemi zgjeruar programin tonë të praktikës në bashkëpunim me CSR Kosova, duke ofruar përvojë praktike për 17 të rinj profesionistë në departamente si IT, Juridik, Laborator dhe Mirëmbajtje, duke ndihmuar në pajisjen e gjeneratës së ardhshme me aftësi për të pasur sukses në tregun e sotëm të punës.

Në TITAN SHARRCEM, qëndrueshmëria nuk është një objektivi i izoluar, ajo është e ngulitur në mënyrën se si operojmë, inovojmë dhe bashkëpunojmë. Qoftë përmes programeve tona për shëndet dhe siguri, partneriteteve me komunitetin apo përkushtimit tonë ndaj transparencës dhe qeverisjes së përgjegjshme, ne synojmë të udhëheqim me shembull.

Dua të falënderoj punonjësit tanë, kontraktorët, furnitorët, anëtarët e komunitetit, miqtë dhe partnerët, të cilët kontribuojnë çdo ditë në suksesin tonë të përbashkët. Së bashku, dhe me mbështetjen e Grupit TITAN pas nesh, ne nuk po ndërtojmë vetëm çimento, ne po ndërtojmë një të nesërme më të mirë.

Me respekt,



Behar Disha
Drejtore Menaxhues

KUSH ËSHTË TITAN GROUP

Një Trashëgimi e Inovacionit dhe Rritjes së Qëndrueshme

TITAN është një kompani ndërkombëtare udhëheqëse në prodhimin e materialeve për ndërtim dhe infrastrukturë, e përkushtuar për të ofruar zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme për shtëpi, ndërtesa dhe projekte infrastrukturore. Me një histori mbi 120 vjeçare, ne vazhdojmë të evoluojmë duke përqafuar digjitalizimin, operacionet me emetime të ulëta karboni dhe teknologjitë më të avancuara të ndërtimit.

Të nxitur nga urbanizimi dhe rritja e popullsisë, ne përdorim pikat tona të forta për të përmbushur kërkesat në rritje globale. Qasja jonë e orientuar drejt klientit përfshin bashkëpunim të hershëm, efikasitet të shtuar përmes inteligjencës artificiale, dhe zgjidhje të përshtatura që përmirësojnë rezultatet në ndërtim.

Në qendër të
suksesit tonë janë
njerëzit tanë

”

25+
Shtete

240
Pika
Operimi

6,000
Punonjës


tanë lulëzojnë në një mjedis pune
gjithëpërfshirës, të drejtë dhe të sigurt.



Vlerat Tona

Një kompani me një qëllim të qartë ka nevojë për vlera të forta në thelb. Ato formësojnë kulturën tonë, udhëheqin veprimet tona dhe na frymëzojnë për të përmbushur misionin tonë.

Qëllimi ynë, të kontribuojmë në një botë më të sigurt, të qëndrueshme dhe të këndshme për të jetuar, ***udhëhiqet nga këto vlera thelbësore***:




NE KUJDESEMI

Kujdesi është më shumë se një fjalë, është një përgjegjësi. Ai përcakton mënyrën se si ndërveprojmë me botën dhe parimet që udhëheqin veprimet tona.

Ne kujdesemi për:

- Njerëzit tanë
- Klientët tanë
- Komunitetet dhe mjedisin




NE GUXOJMË

Ne përqafojmë sfidat dhe vendosim synime ambicioze që shtynë kufijtë.

Ne guxojmë të:

- Marrim përsipër punë sfiduese
- Jemi të singertë dhe të drejtpërdrejtë
- Jemi inovator
- Mësojmë vazhdimisht




NE NDËRTOJMË PËR TË QËNË TË QËNDRUESHËM

Suksesi i vërtetë ndërtohet mbi një themel vlerash që zgjasin.

Të ndërtosh për të qëndruar do të thotë:

- Të mendosh afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër
- Të nxitësh bashkëpunimin dhe punën në ekip
- Të udhëheqësh përmirësimin e vazhdueshëm



NE ECIM ME VEPRIME, JO VETËM ME FJALË

Veprat flasin më fort se fjalët. Integriteti është në zemër të çdo gjëje që bëjmë.

Kjo vlerë mbështetet nga:

- Arritja e rezultateve
- Jetimi i vlerave tona në praktikë
- Mbajtja e premtimeve tona

Këto vlera janë shtyllat e **Strategjisë 2026**, duke udhëhequr rritjen e gjelbër dhe të qëndrueshme dhe duke forcuar përkushtimin tonë ndaj progresit të përgjegjshëm.

PRODUKTET DHE ZINXHIRI I VLERËS

Produktet

Në TITAN SHARRCEM, jemi të përkushtuar për të ofruar produkte dhe shërbime me cilësi të jashtëzakonshme. Nga dizajni fillestar deri te dorëzimi final, çdo hap i procesit tonë të prodhimit realizohet me kujdes për të garantuar besueshmëri, performancë dhe qëndrueshmëri.

Zinxhiri ynë i furnizimit është ndërtuar për të maksimizuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë, duke siguruar që të përmbushim standardet më të larta, ndërkohë që minimizojmë ndikimin në mjedis. Për më tepër, ne ndjekim politika të rrepta për prokurim dhe rekrutim, duke u dhënë përparësi palëve të interesit lokal sa herë që është e mundur, gjithmonë në përputhje me sistemet ndërkombëtare dhe evropiane të menaxhimit të certifikuar.


ARTIKULLI	SISTEMI I MENAXHIMIT / CERTIFIKIMI	STATUSI
Të gjitha produktet / Llojet e çimentos	CEM II/B-M(W-L)42.5R CEM IV/B (P-W)42.5N CEM IV/B (P-W)32.5R CEM II/C-M (W-P-L)42.5 N MC5 Sharrmall (Prodhim i jashtëm – uzina Usje)	✓ ✓ ✓ ✓
Gjurmët e karbonit (CO ₂)	Sistemi i Menaxhimit të Gjurmëve të Karbonit	Pjesë përbërëse e EMS ISO 14001
Uji	Sistemi i Menaxhimit të Ujit	Pjesë përbërëse e EMS ISO 14001
Mjedisi	ISO 14001	✓
Menaxhimi i Energjisë	ISO 50001	✓
Cilësia	ISO 9001:2015 CE MARK Akreditim ISO 17025:2018	✓
Siguria	ISO 45001:2018	✓
Llogaridhënia	SA 8000/Llogaridhënie Sociale	✓

Zinxhiri i Vlerës

Si një aktor kyç në zinxhirin e vlerës në Kosovë, TITAN SHARRCEM është i përkushtuar për të ofruar produkte dhe zgjidhje të sigurta, të qëndrueshme dhe me kosto efektive për industrinë ndërtimore në rritje në vend.

Operacionet tona përfshijnë prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e çimentos dhe lëndëve të para. Në fabrikën tonë të çimentos në Han të Elezit, ndjekim një proces të saktë prodhimi që përfshin thërrmimin, homogjenizimin, bluarjen, ngrohjen dhe ftohjen e lëndëve të para. Këto materiale, kryesisht marl dhe gëlqeror, sigurohen nga guroret tona në Dimcë dhe Seqishtë.

Për të reduktuar më tej ndikimin tonë mjedisor dhe për të përmirësuar efikasitetin ekologjik, integrojmë gjithashtu lëndë të para alternative si hir i poshtëm, hir fluturues dhe hir piriti nga industri të tjera vendore, duke përfunduar angazhimin tonë ndaj qëndrueshmërisë dhe ekonomisë qarkore.



Klientët Tanë

Në SHARRCEM, çdo vendim që marrim frymëzohet nga nevojat dhe pritshmëritë e klientëve tanë.

Pikëpamjet dhe ndikimi i tyre na shtyjnë të ndjekim vazhdimisht përsosmërinë në cilësinë e produktit, shërbimin dhe qëndrueshmërinë.

Reputacioni ynë si një ofrues i besueshëm është ndërtuar mbi investime të rëndësishme në teknologji, burime njerëzore dhe iniciativa operative që synojnë përmirësimin e efikasitetit, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e shëndetit e sigurisë për fuqinë tonë punëtore.

Klientët dhe partnerët tanë janë në qendër të gjithçkaje që bëjmë. Ne i dëgjojmë me vëmendje dhe u ofrojmë zgjidhje që jo vetëm i përmbushin, por shpesh i tejkalojnë pritshmëritë e tyre. Me përkushtim ndaj transparencës, ndershmërisë dhe përgjegjësisë, sigurojmë që klientët tanë të jenë të informuar dhe të përfshirë në çdo hap të procesit.



POLITIKAT DHE VLERAT E MENAXHMENTIT

Në TITAN SHARRCEM sigurojmë kushte optimale pune përmes Sistemeve të Menaxhimit të Certifikuara Ndërkombëtarisht dhe Evropianisht. Certifikimi ynë Eurocert SA 8000 reflekton përkushtimin tonë ndaj mirëqenies së punonjësve dhe praktikave etike të punës.

Përmes Labororit për Aktivitetet e Biznesit (LAB), ne mbështesim ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) me ndihmë financiare dhe teknike, duke forcuar më tej rolin tonë në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës.

Për të ruajtur integritetin, llogaridhënien dhe përputhshmërinë me rregulloret, ndjekim Kodin e Sjelljes dhe Politikat e Grupit TITAN, të cilat përfshijnë luftën kundër ryshfetit dhe korrupsionit, respektimin e ligjit për konkurrencën, kujdesin për shëndetin dhe sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, përgjegjësinë shoqërore të korporatës, respektimin e të drejtave të njeriut, procesin e raportimit të parregullsive si dhe mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave. Duke u përmbajtur këtyre parimeve, ne kultivojmë një mjedis pune dhe biznesi që është transparent, i përgjegjshëm dhe etik.

Shpërndarja e Vlerës për të Gjithë

Ekipi i përkushtuar i TITAN SHARRCEM është i angazhuar për të përmirësuar botën përmes praktikave etike dhe të përgjegjshme të biznesit.

I frymëzuar nga udhëheqja e Grupit TITAN në progresin social dhe mjedisor, ne investojmë burime të konsiderueshme për të përfituar palët tona të interesit dhe për të kontribuar në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së për vitin 2030.

Qasja jonë ndaj rritjes së qëndrueshme vendos në qendër të operacioneve tona mirëqenien e komunitetit dhe shoqërisë, me bindjen se prosperiteti ynë afatgjatë është i lidhur ngushtë me mirëqenien e të tjerëve.

Kjo bindje pasqyrohet jo vetëm në veprimet tona, por edhe në mënyrën se si shpërndajmë burimet tona. Tabela në vijim paraqet kontributet tona kryesore financiare për vitin 2024, duke treguar qartë se si krijojmë vlerë të prekshme në disa dimensione, nga infrastruktura dhe kujdesi për mjedisin, deri te mirëqenia e punonjësve dhe mbështetja e komunitetit.

Investimet totale (CAPEX) në vitin 2024 (€)	8,085,810 €
Taksa lokale (bashkiake dhe pronësore, të paguara)	63,482 €
Tatimet mbi të ardhurat korporative	3,468,105 €
Kontributet pensionale të punonjësve, të paguara (5% e kontributit të paguar nga Sharrcem)	187,109 €
Investimet në mjedis, shëndet dhe sigurinë në punë	461,703 €

VLERËSIMI I MATERIALITETIT DHE ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT

Çështjet Materiale



Në TITAN SHARRCEM, ne i japim përparësi identifi kimit dhe adresimit të çështjeve materiale për të nxitur suksesin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë, duke përbushur njëkohësisht angazhimet tona ndaj komunitetit dhe mjedisit.

Në vitin 2020, TITAN integroi Kornizën e Bordit të Standardeve të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SASB) në përgatitjen e deklaratave të performancës ESG, me qëllim që të adresonte në mënyrë të duhur çështjet ESG që kanë rëndësi fi nanciare. Korniza e SASB u përdor për të lidhur Hartën e Materialitetit të SASB me Vlerësimin e Materialeve të Grupit për vitin 2020, duke mundësuar përputhshmëri midis Grupit dhe degëve të tij.

Duke përdorur Hartën e Materialitetit të SASB, SHARRCEM vlerësoi çështjet materiale dhe ndikimin e tyre. “Kapitali Social” u identifi kua si përparësia kryesore, duke refl ektuar fokusin tonë të fortë në angazhimin me komunitetin, i ndjekur nga “Kapitali Njerëzor”, që thekson mirëqenien dhe përfshirjen e punonjësve.

Në Vlerësimin e Materialitetit për vitin 2020, ne identifi kuam tetë çështje me përparësi të lartë, të cilat janë të ndërlidhura me katër Fushat Kryesore të Fokusit të Grupit TITAN. Duke i renditur këto çështje sipas ndikimit dhe rëndësisë që ato kanë për palët e interesit, ne forcojmë përkushtimin tonë ndaj qëndrueshmërisë dhe praktikave të përgjegjshme të biznesit.

Për të siguruar vazhdimësinë dhe përputhjen me pritshmëritë e palëve të interesit, Grupi TITAN ndërmori në vitin 2022 një proces të vlefshmërisë së vlerësimeve ekzistuese të materialitetit në të gjitha Njësitë e Biznesit. SHARRCEM përfshiu palët kyçe të interesit përmes një pyetësori për të rivlerësuar rëndësinë e temave të tij materiale. Të dhënat e mbledhura konfi rmuuan se të gjitha çështjet e identifi kuara më parë mbetën të vlefshme dhe në përputhje me pritshmëritë e palëve të interesit. Nuk u propozuan çështje shtesë dhe asnjë temë ekzistuese nuk u kontestua. Si rezultat, nuk u bënë ndryshime në Matricën e Materialitetit të vitit 2020. Megjithatë, SHARRCEM do të marrë parasysh gjetjet e këtij procesi për të informuar ciklin e ardhshëm të materialitetit, i cili është planifi kuar për vitin 2025.



Përputhja e OKB-SDGs 2030 me çështjet materiale të Titan Sharrcem

Vlerësimi i materialitetit vazhdon të tregojë qartë lidhjen midis temave kyçe materiale të TITAN SHARRCEM dhe përputhshmërisë së tyre me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG), të cilat synojnë të nxisin rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm deri në vitin 2030. Ndërsa Kosova mbetet e përkushtuar ndaj këtyre objektivave globale, raporti i TITAN SHARRCEM vazhdon të fokusohet në çështjet materiale që duhet të adresohen deri në vitin 2025, duke reflektuar rëndësinë e tyre në kuadër të gjerë të SDG-ve.

Përgjegjësia shoqërore dhe qasja bashkëpunuese ndaj qëndrueshmërisë mbeten në qendër të strategjisë së Sharrcem, duke udhëhequr iniciativat, veprimet dhe investimet e planifikuara të kompanisë.

Çështje Materiale 2021 - 2025	Kontributi në OZhQ
Mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm	OZhQ3, OZhQ4, OZhQ17
Performanca Mjedisore	OZhQ12, OZhQ13, OZhQ15
Angazhohu dhe Kontribuo	OZhQ1, OZhQ2, OZhQ8, OZhQ11
Qeverisje e Mirë, Transparencë dhe Etikë Biznesi	OZhQ16, OZhQ17
Angazhimi i Punonjësve	OZhQ3, OZhQ4, OZhQ5, OZhQ17
Ndryshimet Klimatike dhe Efikasiteti i Energjisë	OZhQ13, OZhQ17
Vend pune i larmishëm dhe gjithëpërfshirës	OZhQ5, OZhQ10
Zinxhir Furnizimi i Përgjegjshëm, i Besueshëm dhe i Qëndrueshëm	OZhQ8, OZhQ17



Angazhimi me Palët e Interesit

TITAN SHARRCEM angazhohet në mënyrë aktive me një grup të gjerë dhe të larmishëm palësh interesi për të garantuar transparencë, bashkëpunim dhe rritje të qëndrueshme. Nëpërmjet komunikimit të hapur, ne adresojmë shqetësimet e tyre, përshtatim strategjitë tona me pritshmëritë e tyre dhe ndërtojmë partneritete afatgjata me ndikim pozitiv.

Palët tona të interesit përfshijnë:

Punonjësit

**Investitorët dhe
Analistët**

Klientët

Rininë

**Komunitetet Lokale
dhe Qeveritë**

OJQ-të

**Autoritetet
Rregullatore**

Shoqërinë Civile

**Partnerët e Biznesit
dhe Furnitorët**

Mediat

Kontraktorët

**Akademikë dhe
institucionet kërkimore**

**Autoritetet
Vendore**



SHQYRTIMI I PERFORMANCËS NË FUSHËN E ESG-SË

Në vitin 2024, TITAN SHARRCEM vazhdoi të përparojë në performancën e saj Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes (ESG), duke forcuar angazhimin tonë ndaj praktikave etike të biznesit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë.


Gjatë vitit, ne nisëm iniciativa me ndikim, të cilat sollën përmirësime domethënëse në fusha kyçe, duke siguruar që qëndrueshmëria të mbetet në zemër të operacioneve tona.

Qasja jonë shkon përtej angazhimit — ne veprojmë. Përmes iniciativave të planifi kuara dhe të zbatuara me kujdes, ne integrojmë përgjegjësinë mjedisore në biznesin tonë, duke forcuar njëkohësisht partneritetet e forta me komunitetin. Ne gjithashtu i japim përparësi një mjedisi pune gjithëpërfshirës dhe mbështetës, duke krijuar një ndikim pozitiv për punonjësit dhe palët tona të interesit.

Si pjesë e Grupit TITAN, TITAN SHARRCEM është e përkushtuar për të arritur objektivat ambicioze ESG të përcaktuara për vitin 2025 dhe më tej. Këto synime fokusohen në katër shtylla kryesore:

1

**Dekarbonizimi
& Digjitalizimi**



2

**Mjedis Pune që
Mundëson Rritjen**



3

**Ndikim Pozitiv
Lokal**



4

**Furnizim i
Qëndrueshëm**



FUSHA NË FOKUS: DEKARBONIZIMI DHE DIGITALIZIMI

Çështje materiale: Ndryshimet klimatike dhe efi çienca e energjisë

Ndryshimet klimatike dhe dekarbonizimi

TITAN SHARRCEM është e përkushtuar ndaj një të ardhmeje të qëndrueshme, në përputhje me vizionin e Grupit TITAN “Të ndërtojmë së bashku një botë më të mirë”. Ne i japim përparësi edukimit mjedisor, operimeve të përgjegjshme dhe parandalimit të ndotjes për të minimizuar ndikimin tonë. Si pjesë e angazhimit tonë për të ulur gjurmën mjedisore, kemi zhvilluar një plan të plotë dekarbonizimi që mbështet planin e Grupit TITAN për uljen e karbonit. Ne përmirësojmë vazhdimisht performancën tonë mjedisore duke zbatuar sisteme të forta menaxhimi, duke monitoruar progresin dhe duke përfshirë palët e interesuara në përpjekjet tona.

Ne i japim përparësi transparencës duke ndarë rregullisht progresin tonë dhe duke integruar praktika të qëndrueshme në të gjitha operacionet tona. Audit i Sistemit të Menaxhimit Mjedisor u krye më 16-17 dhjetor 2024 nga organi i jashtëm i certifi kimit, EUROCERT, në përputhje me standardin EN ISO 14001:2015. Vlerësimi i performancës sonë mjedisore ishte jashtëzakonisht pozitiv, pa asnjë problem apo mospërputhje të evidentuar. Për më tepër, ne kemi monitoruar vazhdimisht emetimet nga burimet kryesore dhe kemi ndërmarrë masa proaktive për të siguruar cilësinë optimale të ajrit dhe për të minimizuar zhurmën mjedisore si brenda ashtu edhe rreth impianteve dhe gurave tona. Ne kemi kryer gjithashtu monitorim të rregullt të ujërave nëntokësore dhe shkarkimit të ujërave të ndotura nga impianti ynë i trajtimit, për të parandaluar çdo ndikim negativ në ekosistemin lokal nga aktivitetet tona.

Fabrika arriti të ulë emetimet e CO₂ përmes disa masave, si zëvendësimi i CEM IV B 42.5 N me CEM II C-M 42.5 N, duke ulur faktorin e klinkerit me mbi 2% për këtë lloj çimentoje, gjë që kontribuoi në reduktimin e më shumë se 17 kg CO₂/t për këtë çimento dhe optimizimin e mëtejshëm të faktorit të klinkerit për CEM IV B 32.5 R dhe CEM II B 42.5 R. Gjithashtu, fabrika ka lobuar me sukses pranë autoriteteve për miratimin e standardit të ri EN 197-5 dhe ka certifikuar me sukses CEM II C-M 42.5 N, duke hedhur në treg llojin e ri të çimentos.



Themelimi i Laboratorit të Betonit



Në maj të vitit 2024, TITAN SHARRCEM bëri një hap të rëndësishëm drejt inovacionit dhe qëndrueshmërisë me hapjen e Labororit të Betonit, një qendër moderne dhe e teknologjisë së avancuar. Ky moment shënon përfundimin e angazhimit të kompanisë për të ofruar shërbime teknike të nivelit të lartë, duke kontribuar njëkohësisht në uljen e gjurmës së karbonit në sektorin e ndërtimit.

Laboratori ofron testime dhe analiza të avancuara të agregateve dhe betonit, duke ndihmuar klientët të optimizojnë aditivët dhe të maksimizojnë performancën e çimentos. I akredituar nga DAK sipas standardit ISO/IEC 17025, ai garanton standarde të larta kompetence, paanshmërie dhe konsistence në testime.

Si përfaqësues ekskluziv i aditiveve Chryso në tregun vendas, TITAN SHARRCEM forcon më tej pozitën e tij në ofrimin e cilësisë dhe inovacionit. Chryso, pjesë e Saint-Gobain Group, është lider global në kimikatet për ndërtim. Ky bashkëpunim rrit kapacitetet tona të mbështetjes teknike dhe u ofron klientëve akses në aditiv me performancë të lartë që përmirësojnë punueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë mjedisore.



Rritja e efikasitetit përmes optimizimit në kohë reale

Në TITAN SHARRCEM, ne kemi përmirësuar proceset tona të prodhimit duke zbatuar një sistem Optimizimi në Kohë Reale (RTO) në Mulli të Papërpunuar, Mulli Çimentoje dhe Furrë. Ky përditësim ka forcur efi kasitetin, stabilitetin e procesit dhe performancën e përgjithshme të fabrikës.

Sistemi përdor analiza të të dhënave në kohë reale, modelim parashikues dhe inteligjencë arti ciale për të bërë rregullime të sakta, duke ulur konsumin e energjisë, minimizuar devijimet e procesit dhe përmirësuar cilësinë e produktit. Këto përmirësime na lejojnë të arrijmë objektivat e prodhimit në mënyrë më efektive, duke përdorur burimet në mënyrë më efi kase.

Duke adoptuar mjete të avancuara digjitale, ne vazhdojmë të optimizojmë operacionet dhe të rrisim besueshmërinë. Zbatimi i suksesshëm i RTO-së mbështet automatizimin dhe përmirësimet e vazhdueshme të proceseve, duke forcur angazhimin tonë për efi kasitet dhe qëndrueshmëri në prodhimin e çimentos.



Projekti “Muzika e ngirë” Garë Arkitekture



Për të inkurajuar gjeneratën e ardhshme të arkitektëve dhe inxhinierëve që të përqafojnë qëndrueshmërinë, TITAN SHARRCEM prezantoi projektin Muzika e Ngirë, një garë dizajni i fokusuar në zgjidhje ndërtimore miqësore me mjedisin. Iniciativa ftoi studentët të arkitekturës dhe inxhinierisë civile të zhvillonin projekte inovative për hyrjen e fabrikës, duke përdorur praktika të qëndrueshme me çimenton si material bazë.

Gara shërbeu si një platformë për të shtyrë kufi jtë e dizajnit të qëndrueshëm, në përputhje me vizionin e TITAN SHARRCEM për të promovuar përgjegjësinë mjedisore në sektorin e ndërtimit. Në total, morën pjesë 13 grupe studentësh nga Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), ku një ekip fitues nga secili universitet u shpërblye me 5,000 € gjatë një eventi festiv në nëntor 2024.

Duke nxitur kreativitetin dhe ndërgjegjësimin për zgjidhje ndërtimore të gjelbra, projekti synoi të frymëzojë profesionistët e rinj që të zhvillojnë dizajne vizionare dhe të ndërgjegjëshme për mjedisin. Përmes projektit Muzika e Ngirë, TITAN SHARRCEM forcon përkushtimin e tij ndaj qëndrueshmërisë, edukimit dhe inovacionit, duke siguruar që gjeneratat e ardhshme të pajisen me njohuri dhe frymëzim për të kontribuar në një mjedis të ndërtuar më të gjelbër.



Dita e Hapur



Në kuadër të projektit Muzika e Ngirë, TITAN SHARRCEM organizoi një aktivitet Ditë e Hapur për studentët e arkitekturës nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe UBT, duke i njohur ata me Konkursin e Dizajnit Arkitekturor Muzika e Ngirë.

Studentët vizituan fabrikën e çimentos dhe ambientet e saj, përfshirë hyrjen që do të ridizajnohej bazuar në projektin fitues. Ky aktivitet u ofroi studentëve njohuri të vlefshme, duke mbështetur si zhvillimin e tyre akademik ashtu edhe pjesëmarrjen në konkurs.

TITAN SHARRCEM vazhdon të mbështesë talentet e reja, duke ofruar bursa, praktika profesionale dhe mundësi punësimi, veçanërisht në fusha që lidhen me qëndrueshmërinë.



Transformimi Digital përmes zbatimit të SAP

Në vitin 2024, ne hodhëm një hap të madh në transformimin tonë digital duke lançuar me sukses sistemin SAP më 1 janar. Pas dy dekadash të përdorimit të sistemeve të vjetra si Sun Systems, COSWIN dhe SAT Weighbridge, kemi kaluar në SAP, një zgjidhje moderne ERP, së bashku me TSI për procesin e ngarkim-shkarkimit.

Ky përditësim përmirëson efikasitetin operativ dhe thjeshton proceset. Sistemet e reja janë plotësisht të integruara me Titan UP, portalin ynë për klientët, i cili thjeshton menaxhimin e porositve dhe ofron analiza të vlefshme, duke përmirësuar ndërveprimin me klientët.

Duke zbatuar SAP, kemi digjitalizuar proceset bazë të biznesit, kemi standardizuar operacionet në të gjithë organizatën dhe kemi përmirësuar konsolidimin e të dhënave dhe raportimin në kohë reale. Këto përpime mundësojnë marrjen e vendimeve më të shpejta dhe më të informuara, duke siguruar që të vazhdojmë të ofrojmë vlerë më të madhe për klientët dhe palët e interesuara, ndërkohë që nxisim inovacionin dhe përsosmërinë operacionale.



Përmirësimet në Sigurinë Kibernetike

Në vitin 2024, TITAN SHARRCEM bëri përpime të dukshme në forcimin e kornizës së saj të sigurisë kibernetike për të mbrojtur konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemeve digjitale. Masat kryesore përfshinë forcimin e infrastrukturës IT përmes konfigurimeve të përmirësuar, shtresave shtesë të sigurisë dhe segmentimit të rrjetit për të kufizuar dobësitë e mundshme. Rrjetet pa tela u përditësuan për të ofruar qasje më të sigurt dhe më të qëndrueshme si për përdoruesit e brendshëm ashtu edhe për ata vizitorë.

Sistemet e teknologjisë operative patën gjithashtu përmirësime me integrimin e mjeteve të reja të sigurisë që synojnë menaxhimin më të mirë të rrezikut dhe zbulimin e kërcënimeve. Ndërkohë, ndërgjegjësimi i punonjësve mbeti një fokus thelbësor, me simulime të rregullta phishing dhe sesione trajnimit të synuara për përdoruesit me risk më të lartë, për të forcuar sjelljet e sigurt. Këto veprime pasqyrojnë qasjen proaktive të TITAN SHARRCEM për t'u përshtatur ndaj kërcënimeve kibernetike në zhvillim dhe për të ruajtur një mjedis digjital të sigurt.

FUSHA NË FOKUS: MJEDISI I PUNËS QË MUNDËSON RRITJEN

Çështje materiale: Mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm për punonjësit tanë dhe partnerët e biznesit përgjatë zinxhirit të vlerës

Shëndeti dhe Siguria

Në TITAN SHARRCEM, siguria mbetet prioriteti ynë kryesor. Ne e njohim rrezikun e natyrshëm që mbart prodhimi i çimentos dhe operacionet në gurore, dhe jemi të përkushtuar të mbrojmë punonjësit, kontraktorët dhe palët e interesuara përmes përmirësimeve të vazhdueshme. Me mbështetjen e TITAN Group, kemi forcuar politikat tona të Shëndetit & Sigurisë, duke siguruar një qasje proaktive ndaj menaxhimit të rrezikut, parandalimit të aksidenteve dhe shmangies së përsëritjes së incidenteve.

Korniza jonë gjithëpërfshirëse për sigurinë përfshin inxhinierë të dedikuar për shëndetin dhe sigurinë në të gjitha njësitë e prodhimit, hetime sistematike të incidenteve, planifi kim proaktiv dhe programe të vazhdueshme trajnimi. Ne i kushtojmë rëndësi vendosjes së objektivave të matshme të sigurisë, monitorimit të progresit dhe vlerësimeve të vazhdueshme nga profesionistë të certifikuar të sigurisë në të gjitha lokacionet operative. Respektimi rigoroz i procedurave të përcaktuara të sigurisë, trajnimi i rregullt dhe fushatat e ndërgjegjësimit janë elemente thelbësore të kulturës sonë të sigurisë.

Në vitin 2024, TITAN SHARRCEM ka vazhduar të ndërtojë mbi rekordin e saj të fortë në fushën e sigurisë, duke ruajtur zero incidente me humbje kohe pune (LTI) si për personelin ashtu edhe për kontraktorët. Qasja jonë proaktive, sistemet e përmirësuara të monitorimit dhe angazhimi i punonjësve në nismat për sigurinë kanë qenë vendimtare në krijimin e një mjedisi pune më të sigurt dhe më të shëndetshëm. Ne mbetemi të përkushtuar në forcimin e kulturës sonë të sigurisë, duke siguruar që të gjithë punonjësit dhe partnerët të operojnë nën standardet më të larta të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Pikat kryesore të performancës në Shëndet & Siguri (H&S)

Zero LTI

Auditimi Green 360

Planet e shpëtimit për hapësirat e mbyllura dhe punën në lartësi

Përmirësime të sigurisë bazuar në gjetjet nga auditimet

Fushata/trajnime për ngasjen e sigurt dhe vlerësimi i shoferëve

Përmirësime strukturore (plani i punimeve civile)

Përmirësimi i nisësit të lëngshëm të vajit për motorin e mullirit të papërpunuar 2.2 MW


Inspektimi/Reparimi i ndërtesave të mbuluara me fletë metalike

Pajisje shpëtimi


Përmirësim i djegësit (fail-safe)

KPI-të - Vonesa

LTIFR-Personeli ynë




LTIFR-Kontraktorë



KPI-të Kryesuese

Orët e trajnimit / Punonjës



Ekipi më i mirë për promovimin e shëndetit dhe sigurisë në punë

Si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm për sigurinë në vendin e punës dhe mirëqenien e punonjësve, TITAN SHARRCEM organizoi ngjarjen “Ekipi Më i Mirë për Promovimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”.

Kjo iniciativë synonte të njihte dhe shpërblente ekipet që treguan sukses të jashtëzakonshëm në zbatimin e praktikave të shëndetit dhe sigurisë, duke forcuar një kulturë ku siguria është një vlerë e përbashkët.

Ngjarja u ndoq nga rreth 50 pjesëmarrës, përfshirë përfaqësues nga TITAN SHARRCEM, komuniteti lokal i Hanit të Elezit, si dhe institucione dhe organizata të ndryshme. Ndër pjesëmarrësit kryesorë ishin zyrtarë të qeverisjes lokale, përfaqësues nga institucionet e shëndetit dhe sigurisë, agjenci të zbatimit të ligjit dhe partnerë të industrisë.

Gjatë aktivitetit, disa individë u vlerësuan për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në sigurinë në vendin e punës. Si shenjë mirënjohjeje, secili anëtar i ekipit të shpërblyer mori një shpërblim.



Çmimi për iniciativat më të mira dhe përmirësimin e vazhdueshëm

TITAN SHARRCEM u nderua me Çmimin për Iniciativat më të Mira dhe Përmirësimin e Vazhdueshëm për performancën e tij në fushën e shëndetit dhe sigurisë gjatë vitit 2024.

Ky vlerësim nga Grupi TITAN pasqyron angazhimin tonë të vazhdueshëm për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së të gjithë punonjësve dhe kontraktorëve. Ai thekson përpjekjet e pandërprera të ekipit tonë për të zbatuar praktika efektive dhe për të nxitur një kulturë të fortë sigurie në të gjitha operacionet tona.

Në SHARRCEM, siguria mbetet prioritet kryesor. Ky çmim na inkurajon të vazhdojmë fokusin tonë në përmirësimin e vazhdueshëm dhe pjesëmarrjen aktive në nismat e përbashkëta të Grupit, ndërsa punojmë për të siguruar një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë.

Trajnimi për Ndhimën e Parë:

Përmirësimi i sigurisë në vendin e punës dhe gatishmëria në raste emergjente Preparedness

Një trajnim gjithëpërfshirës për ndihmën e parë u zhvillua nga një trajner i certifikuar i Kryqit të Kuq të Kosovës, duke pajisur pjesëmarrësit me aftësi jetike për shpëtimin e jetës. Kjo iniciativë u krijua për të rritur sigurinë dhe gatishmërinë në vendin e punës, duke siguruar që punonjësit të mund të reagojnë në mënyrë efektive në situata emergjente.

Trajnimi përfshiu një gamë të gjerë temash thelbësore, përfshirë përgjegjësitë ligjore për ofrimin e ndihmës së parë, vlerësimin dhe sigurimin e skenës së një emergjence, si dhe dhënien e kujdesit të menjëhershëm për personat e lënduar. Pjesëmarrësit morën udhëzime praktike mbi reanimimin kardiopulmonar (CPR), teknikat për ndalimin e gjakderdhjes së rëndë dhe menaxhimin e dhurur të plagëve. Për më tepër, ata u trajnuan për të përballuar situata të ndryshme mjekësore emergjente, duke forcuar aftësinë e tyre për të vepruar shpejt dhe me besim kur është e nevojshme.

Me pjesëmarrjen e 118 punonjësve dhe kontraktorëve, programi e zgjeroi ndjeshëm kapacitetin e reagimit emergjent të TITAN SHARRCEM. Duke pajisur një numër kaq të madh pjesëmarrësish me trajnime të rëndësishme të ndihmës së parë, ky program rrit ndjeshëm sigurinë dhe gatishmërinë në vendin e punës, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë.

NISMAT PËR MIRËQENIEN

Duke mbështetur angazhimin e Grupit TITAN për një mjedis pune të sigurt dhe mbështetës, ne e vendosim në prioritet mirëqenien fizike, mendore, sociale dhe financiare të punonjësve tanë. Këto përpjekje mbeten një fokus kyç gjatë vitit 2024 dhe më tej. Gjatë vitit, SHARRCEM organizoi 3 iniciativa të fokusuara në mirëqenien fizike, 13 sociale, 5 financiare dhe 3 mbi shëndetin mendor, për të mbështetur në mënyrë gjithëpërfshirëse fuqinë punëtore.

Në përputhje me angazhimin tonë për mirëqenie fizike dhe sociale, SHARRCEM zhvilloi fushatën e saj vjetore për dhurimin e gjakut në ambientet e kompanisë, ku morën pjesë gjithsej 112 persona, 80 prej të cilëve ishin punonjës të TITAN dhe 32 anëtarë të komunitetit lokal. Kjo nismë jo vetëm që mbështet shëndetin publik, por gjithashtu forcon kulturën tonë të kujdesit dhe solidaritetit.

Programi i Asistencës për Punonjësit (EAP) vazhdon të shërbejë si një burim i vlefshëm, duke ofruar mbështetje profesionale dhe konfidenciale për punonjësit dhe familjet e tyre që përballen me sfida personale, familjare ose të lidhura me punën. Duke u mbështetur në një traditë të gjatë të kujdesit ndaj punonjësve, programi luan një rol thelbësor në promovimin e mirëqenies mendore dhe emocionale, duke rritur njëkohësisht produktivitetin e përgjithshëm.

Këtë vit, ne po forcojmë më tej iniciativat për mirëqenie duke nxitur balancën punë jetë, duke rritur ndërgjegjësimin për shëndetin mendor dhe duke zgjeruar aktivitetet e mirëqenies që kontribuojnë në një kulturë pune pozitive dhe të zhvilluar.

 Fizike	 Sociale	 Financiare	 Mentale
- Mjek i Kompanisë - Kontroll mjekësor - Trajnim për ushqim të shëndetshëm - Kontroll parandalues të dizajnuara për punonjëset femra (test PAP dhe ultratinguj i gjirit)	Dhurim gjaku (dy herë në vit)	- Sigurim Shëndetësor - Sigurim Jete - Vakte falas - Kupona - Dhuratë për Festa Fetare - Kafe dhe çaj falas	- EAP - Lulëzo

ANGAZHIMI DHE ZHVILLIMI I PUNONJËSVE

Kompania jonë njeh se suksesi i saj bazohet në përpjekjet e përbashkëta të punonjësve dhe mbetet e përkushtuar ndaj rritjes dhe zhvillimit të tyre.

Përmes Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMS), ne tërheqim, mbajmë dhe zhvillojmë në mënyrë strategjike talentet që përputhen me vlerat tona bazë. Të dhënat e marra nga HRMS i Grupit TITAN mbështesin vendimmarrjen e bazuar në analiza dhe përmirësimin e vazhdueshëm në menaxhimin e fuqisë punëtore. Ne i japim prioritet punësimit lokal për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit dhe rritjen ekonomike. Kultura jonë organizative është ndërtuar mbi parimet e diversitetit, drejtësisë dhe bashkëpunimit, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës ku të gjithë punonjësit mund të zhvillohen. Duke u fokusuar te njerëzit, angazhimi dhe menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore, ne mbetemi të përkushtuar për të maksimizuar potencialin e fuqisë sonë punëtore.

Në vitin 2024, TITAN SHARRCEM demonstroi një përkushtim të fortë ndaj zhvillimit të punonjësve duke ofruar mundësi të gjera trajnimi.



8,153
orë trajnim

ofruar nga kompania jonë



233
punonjës
të trajnuar me sukses



686 orë

e dedikuar për trajnimin e
punonjësve femra



19
punonjëse



7,467 orë

e alokuar për trajnimin e
punonjësve meshkuj



214
punonjës

Retreat trajnimi në Shqipëri

Forcimi i lidhjeve dhe fuqizimi i ritjes

SHARRCEM vazhdon të investojë në zhvillimin e punonjësve përmes një partneriteti të çmuar me një institucion të njohur austriak. Në vitin 2024, programi u zgjerua për të përfshirë të gjithë pjesëmarrësit e Programit të Zhvillimit Profesional (PDP). Një nga momentet kulmore ishte retreat-i në Shqipëri, i cili kombinoi aktivitete për ndërtimin e ekipit dhe punëtori për të forcuar bashkëpunimin, komunikimin dhe një kulturë pune mbështetëse. Nga 65 punonjës të përfshirë në PDP, 45 morën pjesë në këtë retreat, duke reflektuar angazhim të lartë dhe përkushtim ndaj rritjes personale dhe profesionale.

Trajnim për shëndetin mendor

Si pjesë e nismave për mirëqenie, TITAN SHARRCEM organizoi një trajnim mbi shëndetin mendor për të rritur ndërgjegjësimin dhe për t'u dhënë punonjësve mjete për të prioritetizuar shëndetin e tyre psikologjik. Trajnimi mbuloi tema kyçe si bazat e mirëqenies mendore, çrregullimet psikosomatike, zbulimi i hershëm i shqetësimeve mendore dhe çështje si depresioni, ankthi dhe sulmet e panikut.

Një fokus i rëndësishëm ishte Ndhima e Parë për Shëndetin Mendor, duke u mësuar pjesëmarrësve të njohin shenjat paralajmëruese, të ofrojnë mbështetje fi llestare dhe të inkurajojnë kërkimin e ndihmës profesionale. Në trajnim morën pjesë 62 punonjës, duke dëshmuar angazhim të fortë dhe duke përforcuar përkushtimin tonë kolektiv ndaj mirëqenies mendore.



Trajnim mbi mirëqenien

189 punonjës morën pjesë në një trajnim katërditor të fokusuar në mirëqenie, fi tnes dhe ushqyerje. Programi kombinoi teori dhe praktikë, duke mbuluar teknikat e sigurta të ngritjes, dietat e balancuara dhe efektet shëndetësore të pirjes së duhanit. Sesionet interaktive sfi duan perceptimet e zakonshme mbi intolerancën ushqimore dhe dietat, duke nxitur diskutime të hapura dhe duke përforduar angazhimin e SHARRCEM për një kulturë pune të shëndetshme.



Ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit – nisma “Muaji Rozë”

Si pjesë e përkushtimit të saj ndaj mirëqenies së punonjësve dhe angazhimit në komunitet, SHARRCEM mbështeti aktivisht Muajin Rozë, një nismë globale për rritjen e ndërgjegjësimit mbi kancerin e gjirit. Në bashkëpunim me Komunën e Hanit të Elezit dhe institucionet lokale shëndetësore, u mundësua qasja në aktivitete sensibilizuese dhe të kujdesit parandalues për punonjëset femra.

Gjatë muajit, u ofruan kontrolle mjekësore falas, përfshirë ekzaminime me ultratinguj të realizuara nga një specialist radiologjie. Gjithashtu, punonjëset morën pjesë në një shfaqje teatrale dhe një ligjëratë edukative nga një kirurg i specializuar, e fokusuar në masat parandaluese për kancerin e gjirit, duke forcuar angazhimin e SHARRCEM për kujdes parandalues dhe mirëqenien e punonjësve.



Retreat për fuqizimin e grave

Për të mbështetur zhvillimin personal dhe kohezionin e ekipit, TITAN SHARRCEM organizoi një retreat për 15 punonjëse, të frymëzuar nga sugjerimet e tyre. Retreat-i ofroi një mundësi unike për zhvillim profesional dhe personal në një ambient natyror të qetë.

Programi përfshiu sesione trajnimi të udhëhequra nga ekspertë, aktivitete mbi mindfulness dhe klasa të udhëhequra të yogës dhe meditimit, duke nxitur një qasje holistike ndaj mirëqenies. Duke krijuar një hapësirë për refl ektim, mësim dhe lidhje ekipore, SHARRCEM forcoi përkushtimin e saj për të mbështetur mirëqenien e përgjithshme dhe zhvillimin profesional të punonjësve.

FUSHA NË FOKUS: NDIKIM POZITIV NË NIVEL

*Çështje materiale:
Performanca mjedisore*



Mjedisi

Në operacionet tona të përditshme, ne i japim përparësi menaxhimit efektiv mjedisor duke iu përmbajtur standardeve të industrisë, duke minimizuar ndotjen dhe duke zbatuar masa korrigjuese për të parandaluar çdo ndikim mjedisor që mund të rezultojë nga aktivitetet tona.

Vazhdojmë të përpikemi të përmirësojmë performancën tonë mjedisore, edhe përballë kushteve të vështira ekonomike. Synimi ynë është të thellojmë kuptimin e sfi dave mjedisore specifi ke për SHARRCEM, ndërkohë që vendosim sisteme të fuqishme të menaxhimit mjedisor për të monitoruar dhe matur progresin tonë. Duke përfshirë palët e interesuara, duke raportuar në mënyrë transparente për performancën dhe duke integruar praktika të qëndrueshme në operacionet tona, ne nxisim një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm.

Për herë të dytë, TITAN SHARRCEM është pajisur me lejen IPPC (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes) në Kosovë. E lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifi kimit Hapësinor, kjo leje nënvizon përkushtimin tonë të vazhdueshëm për monitorimin dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore. Ajo gjithashtu refl ekton transparencën e operacioneve tona dhe përputhshmërinë e vazhdueshme me standardet e industrisë. Duke e dëshmuar më tej këtë angazhim, Audit i Sistemit të Menaxhimit Mjedisor u krye më 16–17 dhjetor 2024 nga trupi i jashtëm i certifi kimit EUROCERT, në përputhje me standardin EN ISO 14001:2015. Performanca jonë u vlerësua shumë lartë, pa gjetje apo mospërputhje, duke rikonfi rmuar efektivitetin e praktikave tona të menaxhimit mjedisor.



Emetimet në Ajër

TITAN SHARRCEM ka ruajtur angazhimin e saj për monitorim të vazhdueshëm mjedisor përmes Sistemit të Vazhdueshëm të Monitorimit të Emetimeve (CEMS), i cili është në funksion që nga viti 2013. Në vitin 2024, përqendrimet mesatare vjetore të emetimeve të SO_x dhe NO_x nga oxhaku i furrës mbetën dukshëm nën Vlerat e Emetimeve (EV) dhe Vlerat Kufi tare të Emetimeve (ELV) të përcaktuara nga rregulloret vendore dhe të BE-së, si dhe nga leja IPPC.

Duke treguar qasjen tonë proaktive, në vitin 2024 u krye një studim fi zibiliteti për reduktimin e NO_x nga kompania YARA Automation Technologies. Gjetjet e studimit do të shërbejnë për fazën e ardhshme, e cila përfshin zbatimin e masave të synuara për të reduktuar më tej emetimet dhe për të përmirësuar performancën mjedisore.

SO_x [mg/Nm³]




Figura 2 Emëtimet SO_x

NO_x [mg/Nm³]




Figura 1 Emëtimet NO_x



Emetimet e Pluhurit

Në një fabrikë çimentoje ekzistojnë dy burime kryesore të pluhurit:

a. Pluhuri nga burime të përcaktuara (Point Source Dust):

Ky pluhur i referohet grimcave që çlirohen nga burime specifi ke si furra, ftohësi dhe oxhaqet e mullirit të çimentos. Matjet tona tregojnë se këto emetime janë dukshëm nën kufi jtë ligjorë. Për të mbajtur nivelet e pluhurit të ulëta, përdorim fi ltra me qese, të cilët mirëmbahen rregullisht për të siguruar funksionimin e tyre optimal.

b. Pluhuri i shpërndarë (Fugitive Dust):

Ky pluhur i referohet grimcave totale që çlirohen nga burime jo të përcaktuara dhe jo të vazhdueshme, si gjatë aktiviteteve të ngarkimit dhe shkarkimit të materialeve, pastrimit dhe mirëmbajtjes. Ai gjithashtu mund të shkaktohet nga era. Për të reduktuar këtë lloj pluhuri, përdorim metoda si spërkatja me ujë, përdorimi i produkteve për kontrollin e pluhurit dhe sigurimi që pajisjet të jenë në gjendje të mirë pune.

Pluhur-Furrë [mg/Nm³]




Figura 3 Emëtimet e Pluhurit - Furra

Pluhur-Ftohësi i Klinkerit [mg/Nm³]




Figura 4 Emëtimet e Pluhuri - CC

Pluhur-Mulliri i Çimentos 2 [mg/Nm³]




Figura 5 Emëtimet e Pluhurit - CEM2



Dita e Tokës 2024



TITAN SHARRCEM e shënoi Ditën e Tokës duke përfshirë nxënësit e klasës së dytë nga shkollat e Hanit të Elezit në një program gjithëpërfshirës të ndërgjegjësimit mjedisor.

Aktiviteti synonte të promovonte qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e mjedisit përmes sesioneve të ndryshme edukative. Këto përfshinin një hyrje mbi rëndësinë e Ditës së Tokës, ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike me diskutime mbi shkaqet, pasojat dhe strategjitë e zbutjes, si dhe këshilla praktike për mbjelljen e pemëve, menaxhimin e mbeturinave dhe transportin miqësor ndaj mjedisit. U zhvillua gjithashtu një sesion interaktiv pyetje-përgjigje për të forcuar kuptimin e fëmijëve.

Përveç komponentëve edukativë, programi përfshinte edhe aktivitete praktike si krijimi i kapelave dhe broshurave me temë Ditën e Tokës, vizatim dhe ngjyrosje. Pjesëmarrësit mbollën gjithashtu pemë të vogla përpara ndërtesës së komunës. Për të theksuar më tej angazhimin e tyre ndaj mjedisit, punonjësit e Sharrcem realizuan një pastrim rreth hapësirës së fabrikës.



Dita Botërore e Mjedisit 2024



Me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, Departamenti i Mjedisit i SHARRCEM-it organizoi një vizitë edukative për nxënësit e shkollës së mesme nga Hani i Elezit në Parkun e Erës të Kitkës në Kosovë.

Kjo nismë synonte të rriste kuptimin e nxënësve mbi burimet e energjisë së rinovueshme dhe të theksonte rëndësinë e praktikave të qëndrueshme në prodhimin e energjisë, si dhe të nxiste ndërgjegjësimin mjedisor tek të rinjtë.

Vizita studimore në Parkun e Erës të Kitkës rezultoi një sukses i madh, duke përmbushur objektivin për të edukuar dhe frymëzuar mendjet e reja mbi rëndësinë e energjisë së rinovueshme. Duke i ekspozuar nxënësit ndaj teknologjisë së avancuar dhe praktikave të qëndrueshme, SHARRCEM dhe Departamenti i Mjedisit dhanë një kontribut domethënës në edukimin dhe avokimin mjedisor. Kjo nismë jo vetëm që festoi Ditën Botërore të Mjedisit, por gjithashtu mbolli farat për një të ardhme më të qëndrueshme përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit.



Rehabilitimi i Guroreve dhe Biodiversiteti

Në vitin 2024, guroret iu nënshtruan procesit të rehabilitimit, i cili përfshinte mbushjen e gropës me 1,320,733 tonë dhe. Kostoja totale për procesin e rehabilitimit/mbushjes së gropës arriti rreth 3,406,604 euro.

Sipas vlerësimit të rrezikut për biodiversitetin të kryer në vitin 2020 për të gjitha vendet e Grupit me përdorimin e Integrated Biodiversity Assessment Tool (IBAT, <https://ibatalliance.org/>), asnjëra nga guroret e SHARRCEM-it nuk është identifi kuar si brenda ose pranë (apo pjesë) zonave me vlerë të lartë biodiversiteti. Për këtë arsye, nuk kërkohen Plane të Menaxhimit të Biodiversitetit për vendet tona.

FOKUSI KRYESOR: NDIKIMI POZITIV LOKAL

LAB (LABORATORI PËR AKTIVITETE BIZNESI)

Për më shumë se një dekadë, Programi LAB, i mbështetur nga SHARRCEM, ka luajtur një rol kyç në zhvillimin rural në Komunën e Hanit të Elezit. Që nga viti 2020, programi e ka zgjeruar fokusin nga agro-pylltaria për të përfshirë edhe investimet në sektorin privat, me synim rritjen e produktivitetit, mbështetjen e inovacionit dhe krijimin e vendeve të punës të qëndrueshme përmes bashkëfi nancimit të pajisjeve teknologjike dhe nismave të reja biznesi.

Për vitin 2024, LAB planifi koi një buxhet prej 84,760 € për të mbuluar aktivitetet e tij. Brenda këtij kuadri, programi mbështeti 16 fermerë në nisjen ose zgjerimin e bizneseve në bletari, blegtori, kultivim frutash, pulërritje dhe pajisje bujqësore. Si përgjigje ndaj një stuhie të fortë breshëri, LAB fi nancoi gjithashtu zëvendësimin e nëntë serave për 11 fermerë të prekur.

Programi miratoi katër projekte të tjera biznesi në vitin 2024, tre për zgjerim biznesi dhe një për një startup inovativ të pajisjeve mjekësore. Në partneritet me Komunën e Hanit të Elezit dhe CNVP, LAB bashkëfi nancoi një projekt të menaxhimit të pyjeve, duke trajtuar pesë hektarë në Dheu i Bardhë dhe duke furnizuar me copëza druri për ngrohjen e dy shkollave lokale.

Programi gjithashtu mundësoi mbështetje teknike, monitorim në terren, trajnim në bujqësi dhe hortikulturë, dhe përfundoi kontrata me 12 furnitorë për dorëzimin e pajisjeve dhe inputeve të nevojshme.

Forcimi i infrastrukturës rurale dhe bujqësisë së qëndrueshme përmes bletarisë

Përpjekjet tona për të mbështetur bujqësinë lokale dhe për të promovuar praktika të qëndrueshme mbeten një prioritet kryesor. Përmes përmirësimeve të synuara të infrastrukturës, synojmë të krijojmë një mjedis që nxit sipërmarrjen dhe rritjen ekonomike në komunitetet rurale. Infrastruktura e përmirësuar u mundëson fermerëve të kenë qasje në mjetet dhe burimet e nevojshme për të modernizuar dhe zgjeruar operacionet e tyre, duke hapur mundësi të reja biznesi dhe duke kontribuar në një sektor bujqësor më të qëndrueshëm.

Si pjesë e kësaj nisme, u mbështetën 5 përfi tues të drejtpërdrejtë, dhe kostoja totale e nismës arriti në 6,000 €. Paralelisht, mbështesim nisma si bletaria, e cila jo vetëm që prodhon produkte të vlefshme si mjalti dhe nënproduktet e bletëve, por gjithashtu luan një rol thelbësor ekologjik në polenizimin e kulturave bujqësore. Kjo kontribuon drejtpërdrejt në sigurinë ushqimore dhe mbështet biodiversitetin, duke forcuar qëndrueshmërinë e sistemeve tona bujqësore.

Këshilli Konsultativ Lokal i Pavarur (ILAB/BOPAL)

Ndërtimi i besimit dhe nxitja e bashkëpunimit me palët e interesit dhe komunitetet lokale vazhdon të jetë një gur themeli i përpjekjeve të përgjegjësive sociale të SHARRCEM-it. Që nga themelimi i tij në vitin 2011, Këshilli Konsultativ Lokal i Pavarur (ILAB) ka shërbyer si një platformë e rëndësishme për përfshirje dhe angazhim transparent. I përbërë nga përfaqësues të komunës, organizatave të shoqërisë civile dhe banorëve lokalë, ILAB është përgjegjës për mbikëqyrjen e shpërndarjes së drejtë të fondit të zhvillimit të komunitetit të TITAN SHARRCEM-it në fusha të identifi kuara si prioritare për mbështetje. Në vitin 2024, SHARRCEM-i ndau 25,000 € për BOPAL-in për të mbështetur zbatimin e këtyre nismave të zhvillimit të komunitetit.

Në vitin 2024, SHARRCEM-i forcoi partneritetin me ILAB përmes zbatimit të disa nismave të zhvillimit të komunitetit. Fokusi kryesor për vitin ishte mbështetja e klubeve sportive lokale. Një total prej 126 individësh, si pjesë e klubeve të mbështetura sportive, përfi tuan nga sponsorizimet, të cilat përfshinin katër klube të dedikuara për futboll, karate dhe mundje. Ky bashkëpunim nënvizon angazhimin e vazhdueshëm të SHARRCEM-it për të promovuar mirëqenien sociale dhe për të nxitur përfshirjen e të rinjve përmes sportit.

Bordi i Fëmijëve

Nisma e Bordit të Fëmijëve të SHARRCEM-it është e përkushtuar për të rritur ndërgjegjësimin tek fëmijët lokalë mbi shëndetin, sigurinë dhe përgjegjësinë mjedisore. E zbatuar në partneritet me autoritetet dhe palët e interesit lokal, programi thekson përmbajtje edukative cilësore që nxit mjedisë të pastra, mirëqenie personale dhe siguri rrugore. Synimi është të arrihen rreth 2,500 të rinj, duke nxitur sjellje dhe qëndrime pozitive që do të përfi tojnë si fëmijët ashtu edhe komuniteti më i gjerë. Gjatë vitit 2024, ndër aktivitete të tjera, SHARRCEM, së bashku me Bordin e Fëmijëve, vazhdoi Programin e Psikologut të Shkollës dhe organizoi festën e Ditës së Fëmijëve në përputhje me përvjetorin e SHARRCEM-it.

Festimi i trashëgimisë dhe së ardhmes: 88-vjetori i Sharrcem dhe Dita e Fëmijëve

Në qershor 2024, SHARRCEM, në bashkëpunim të ngushtë me Bordin e Fëmijëve, shënoi 88-vjetorin e themelimit në kombinim me Ditën e Fëmijëve, duke dëshmuar angazhimin e tij të qëndrueshëm ndaj komunitetit dhe gjeneratave të ardhshme. Në partneritet me Komunën e Hanit të Elezit, Drejtorinë e Kulturës dhe shkollat lokale, SHARRCEM organizoi një program të gjallë për fëmijët në Shtëpinë e Kulturës, ku u shfaq drama edukative “Hana dhe Dielli,” e ndjekur nga rreth 430 fëmijë nga shkollat e Komunës së HIE-së, si dhe këngë, valle tradicionale dhe recitime poezish nga nxënësit lokalë.

Një moment kulmor ishte paraqitja e një pikturë të realizuar nga fëmijët e zonës, që simbolizonte lidhjen e fortë midis SHARRCEM-it dhe komunitetit. Kompania shpërndau gjithashtu balona me ngjyrat e logos së re të TITAN-it dhe realizoi fotografi kreative me fëmijët e komunitetit, duke përfaqësuar identitetin e ri korporativ dhe aspiratat për të ardhmen.

Programi i Psikologut të Shkollës

Si pjesë e përkushtimit të tij për mirëqenien e të rinjve, SHARRCEM, përmes Bordit të Fëmijëve, fi nancoi pagën vjetore të një psikologu që shërben për të gjitha shkollat në Komunën e Hanit të Elezit.

Kjo nismë përfi toi drejtpërdrejt rreth 2,200 nxënës, duke ofruar mbështetje profesionale sociale dhe emocionale. Psikologu luan një rol kyç në ndihmën për nxënësit që të përballojnë sfi da zhvillimore dhe kriza personale, si ngacmimet ose ndarja e prindërve, duke forcuar angazhimin e SHARRCEM-it për të krijuar një ambient mësimor të shëndetshëm dhe mbështetës.



Veprime të mëtejshme për ndikim pozitiv lokal



Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore emergjente – dhurimi i auto-ambulancës nga Sharrcem

Si përgjigje ndaj nevojës për shërbime më të mira shëndetësore emergjente, SHARRCEM i dhuroi një auto-ambulancë Qendrës Mjekësore Publike në Komunën e Hanit të Elezit. Kjo dhuratë synon të përmirësojë qasjen në kujdesin shëndetësor dhe cilësinë e shërbimeve. Nisma thekson ndikimin pozitiv të fi lantropisë korporative në shëndetin publik dhe mirëqenien e komunitetit, duke treguar angazhimin e SHARRCEM-it për përgjegjësi sociale. Nga kjo nismë përfi tojnë të gjithë banorët e Hanit të Elezit, rreth 10,000 persona, duke siguruar që shërbimet mjekësore emergjente të jenë të disponueshme për të gjithë kurdo që nevojiten.



Mbështetja e infrastrukturës rrugore në komunitet

Si pjesë e angazhimit tonë të vazhdueshëm për zhvillimin e komunitetit, ne kontribuam në përmirësimin e infrastrukturës lokale rrugore. Kjo nismë, e cila u fokusua në riparimin dhe përmirësimin e rrugëve kryesore, kishte për qëllim rritjen e sigurisë, qasjes dhe lidhjes në zonën lokale. Me një investim prej 10,940 €, projekti u realizua në bashkëpunim me palët lokale, duke forcuar lidhjet e fqinjësisë dhe duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në jetën e përditshme të banorëve. Ky investim është pjesë e një strategjie më të gjerë për të mbështetur zhvillimin e infrastrukturës lokale dhe për të promovuar rritjen e qëndrueshme afatgjatë të komunitetit.



Programi i praktikës profesionale

SHARRCEM merr pjesë aktive në nisma që mbështesin zhvillimin e të rinjve, duke përfshirë programin Kosovo Generation Unlimited dhe skema të tjera praktike. Në vitin 2024, gjithsej 17 praktikantë përfi tuan nga mundësitë për praktikë profesionale në SHARRCEM, duke fi tuar përvojë praktike dhe aftësi të vlefshme profesionale. Praktikantët u vendosën në departamentet e IT-së, Laboratorit, Ligjorit dhe Mirëmbajtjes, ku morën trajnim praktik në fushat e tyre të studimit.

Programi i Praktikës nën nismën Kosovo Generation Unlimited mbështetet nga Programi i UNICEF në Kosovë dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar. I zbatuar nga Rrjeti CSR Kosovo, ky program synon të nxisë një koalicion shumë sektorial që kontribuon në një agjendë të përbashkët për transformimin e tregut të punës në Kosovë. Qëllimi kryesor i tij është të krijojë mundësi domethënëse për të rinjtë duke adresuar nevojat e paplotësuara në arsim, zhvillim aftësish dhe qasje në punësim.

FUSHA NË FOKUS: FURNIZIM I PËRGJEGJSHËM

Çështje materiale: Performanca mjedisore



Menaxhimi i Ujit

furnizimit dhe shkarkimit, cakton përgjegjësitë për monitorim dhe raportim të vazhdueshëm dhe promovon menaxhimin efi kas të gjithë ciklit të ujit. Investimet në sistemet e riciklimit të ujit dhe përmirësimet në rrjetet ekzistuese kanë kontribuar në një përdorim më efi kas të ujit.

Për më tepër, zbatimi i sistemeve të menaxhimit të ujit, së bashku me instalimin e matësve të rinj të rrjedhës për monitorim më të saktë, kanë përmirësuar ndjeshëm ndjekjen e konsumit të ujit dhe raportimin. Këto përmirësime kanë sjellë një ulje prej rreth 50% të konsumit të ujit krahasuar me vitin e kaluar.

Impianti i trajtimit të ujërave të zeza (WWTP) është në funksion që nga viti 2016. SHARRCEM monitoron cilësinë e ujërave të lëshuara çdo tre muaj përmes laboratorëve të akredituar. WWTP ka funksionuar vazhdimisht pa probleme, dhe rezultatet e analizave kimike të ujit të shkarkuar gjithmonë kanë përmbushur objektivat dhe kufi jtë e përcaktuar nga Udhëzimi Administrativ AI-02/2022. Monitorimi i rregullt kryhet edhe në lumin e vogël Dimce, ku shkarkohet uji i trajtuar.

Në vitin 2024, u krye një studim fi zibiliteti për trajtimin e ujërave sipërfaqësore, ku hapi i ardhshëm është zbatimi i projektit.



Menaxhimi i mbetjeve dhe Ekonomia Çarkore

Janë bërë investime të konsiderueshme në menaxhimin e mbetjeve. Ndërtesa e vjetër e klinkerit është rindërtuar dhe shndërruar në një hapësirë të mbuluar magazinimi, duke kontribuar në uljen e mëtejshme të emetimeve të pluhurit të shpërndarë. Gjithashtu, ndërtesa e kaldajës me avull është rinovuar për t'u përdorur si hapësirë e dedikuar magazinimi për pajisje elektronike, tonera dhe vajra, me të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për ruajtje të sigurt.

Janë bërë përmirësime edhe në zonën e përcaktuar për mbetjet, e cila është riorganizuar në zona të qarta sipas llojit të mbetjeve dhe e pajisur me tabela përkatëse.

Mbetjet menaxhohen sipas praktikave të duhura të asgjësimit dhe riciklimit: mbetjet e përgjithshme dërgohen në vendgrumbullim nga një kompani e licencuar; materialet metalike skrap mblidhen dhe riciklohen nga një kompani e autorizuar; qeset e çimentuara të grisura mblidhen dhe riciklohen nga një operator i licencuar; dhe paketimet plastike hiqen dhe riciklohen në mënyrë të ngjashme. Paletat prej druri ripërdoren brenda kompanisë për shpërndarjen e produkteve të gatshme.



Ekonomia Çarkore

Ne mbetemi të përkushtuar ndaj ekonomisë çarkore duke reduktuar, ripërdorur, ricikluar dhe rikuperuar materiale dhe energji për të mbrojtur burimet natyrore, ulur emetimet e CO₂ dhe menaxhuar në mënyrë efi kase mbetjet. Si pjesë e strategjisë sonë të qëndrueshmërisë, optimizimi i përdorimit të burimeve mbetet një prioritet kryesor.

Në TITAN SHARRCEM, ne e kuptojmë rëndësinë e shfrytëzimit të lëndëve të dyta të para si hiri fl uturues, hiri fundërrues dhe hiri i piritit. Që nga viti 2011, kemi investuar vazhdimisht në partneritete me impiante të palëve të treta për të siguruar përdorimin maksimal të këtyre burimeve. Në vitin 2024, ne kemi përdorur rreth 121,583 ton hiri fl uturues, 6,299 ton hiri fundërrues dhe 2,277 ton hiri piritit. Këto përpjekje kontribuojnë drejtpërdrejt në uljen e gjenerimit të mbetjeve dhe minimizimin e gjurmës sonë mjedisore.

Ne po avancojmë gjithashtu përpjekjet tona për të zëvendësuar pjesërisht lëndët djegëse fosile me lëndë djegëse alternative në proceset tona të prodhimit. Qëllimi ynë është të përdorim Lëndë Djegëse Alternative, të siguruara nga mbeturinat komunale, tregtare dhe industriale, si një burim energjie të qëndrueshëm në procesin tonë të prodhimit. Ky tranzicion kontribuon fuqishëm në objektivat më të gjera mjedisore dhe sjell përfi time të rëndësishme shoqërore për komunitetin tonë.

ZINXHIRI I FURNIZIMIT, KONTRAKTORËT DHE FURNITORËT LOKALË

*Çështje materiale: Furnizim i përgjegjshëm,
i besueshëm dhe i qëndrueshëm*

Në SHARRCEM, ne i kushtojmë rëndësi të madhe zinxhirit tonë të furnizimit dhe partnerëve lokalë, duke njohur rolin e tyre thelbësor në operacionet tona. Si pjesë e Grupit TITAN, jemi të përkushtuar ndaj një qasjeje gjithëpërfshirëse për qëndrueshmëri, si brenda organizatës sonë, ashtu edhe në të gjithë rrjetin tonë të zgjeruar. Duke ofruar një portofol produktesh më të qëndrueshme me performancë të lartë gjatë gjithë ciklit jetësor, nga nxjerrja e lëndëve të para deri te dorëzimi final, ne vazhdimisht përmirësojmë performancën tonë mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG).

Si pjesë e këtij angazhimi, ne promovojmë në mënyrë aktive pajtueshmërinë me standardet ESG tek partnerët tanë në zinxhirin e furnizimit, duke inkurajuar përafrimin me kriteret e qëndrueshmërisë dhe ESG të TITAN-it. Në vitin 2024, shumica e furnitorëve kryesorë për kategoritë globale të prokurimit dhe njësitë individuale të biznesit në të gjitha vendet ku operon Grupi TITAN u përfshinë në procesin e kualifikimit të furnitorëve, i cili përdor kritere të përcaktuara ESG sipas standardeve të TITAN-it. Kjo nismë synon të krijojë një zinxhir furnizimi të përgjegjshëm, transparent dhe të qëndrueshëm.

Në SHARRCEM, të gjithë 12 furnitorët tanë kryesorë u përfshinë dhe përfunduan procesin e kualifikimit në vitin 2024. Secili furnitor u vlerësua kundrejt standardeve ESG të TITAN-it dhe ose i plotësoi kriteret ose zbatoi një plan të qartë përmirësimi. Për më tepër, të gjithë 12 furnitorët janë njohur zyrtarisht me standardet ESG të TITAN-it dhe kanë marrë trajnim për zbatimin e këtyre kriterëve. Këto standarde tani janë përfshirë në mënyrë të detyrueshme në kontratat e tyre, duke forcuar angazhimin tonë të përbashkët ndaj zhvillimit të qëndrueshëm.



QEVERISJA E MIRË, TRANSPARENCA DHE ETIKA E BIZNESIT

TITAN SHARRCEM operon nën Programin gjithëpërfshirës të Përputhshmërisë, të bazuar në menaxhimin e rrezikut të Grupit TITAN, duke siguruar një kornizë të fortë të qeverisjes. Ky program përfshin trajnime të rregullta, monitorim të vazhdueshëm dhe mekanizma mbikëqyrjeje. Përmes Sistemit të Përkujdesit të Duhur të TITAN-it, ne analizojmë, vlerësojmë dhe kontrollojmë me kujdes palët e treta për të identifikuar dhe zbutur rreziqe si ekspozimi ndaj sanksioneve dhe çështjet e integritetit.

Kodi i Sjelljes

Kodi ynë i Sjelljes, së bashku me politikën e Grupit TITAN, ofron rregulla, standarde dhe udhëzime të qarta për punonjësit, furnitorët dhe klientët. Këto dokumente sigurojnë përputhshmërinë me kërkesat e brendshme dhe rregulloret e jashtme, duke adresuar fusha kritike si anti-ryshfeti, të drejtat e njeriut dhe shëndeti e siguria.

Angazhimi ndaj të Drejtave të Njeriut

Në SHARRCEM, ne jemi të përkushtuar të mbrojmë të drejtat e njeriut në të gjitha aspektet e operacioneve tona, në përputhje me udhëzimet e Kombeve të Bashkuara dhe politikën e brendshme të TITAN-it. Ne përdorim mjete si EthicsPoint® për të adresuar në mënyrë konfidenciale shqetësimet e papërshtatshme në vendin e punës. Angazhimi ynë për transparencë dhe qeverisje refl ektohet në certifikimin tonë SA 8000, një dallim që na bën kompania e parë në Kosovë që e arrin këtë standard. Përmes auditimeve të pavarura dy herë në vit, ne sigurojmë vazhdimisht përputhshmërinë, duke zgjeruar këto standarde edhe për kontraktorët tanë. Ky

certifikim forcon harmoninë tonë me Politikën e të Drejtave të Njeriut të Grupit TITAN. Në vitin 2024, 35 punonjës morën gjithsej 9 orë trajnim mbi të drejtat e njeriut, për të forcuar më tej ndërgjegjësimin dhe zbatimin në të gjithë operacionet tona.

Përpyjekjet në Komunikim dhe Përputhshmëri me Politikën

Politikat tona janë të dizajnuara për të nxitur një kulturë integriteti, sjelljeje etike dhe qëndrueshmërie, duke siguruar përputhshmëri si me standardet e brendshme ashtu edhe me rregulloret e jashtme. Politikën kryesore, përfshirë Kodin e Sjelljes dhe ato të Grupit TITAN, komunikohen rregullisht tek punonjësit, furnitorët dhe klientët. Ky komunikim forcohet përmes programeve të synuara të trajnimit dhe burimeve që mbështesin kuptimin dhe zbatimin e këtyre politikave nga të gjitha grupet e palëve të interesuara. Në vitin 2024, 47 individë morën gjithsej 83 orë trajnim mbi Përputhshmërinë, ndërsa 6 punonjës morën pjesë në trajnime mbi Anti-Ryshfetin dhe Korrupsionin. ILAB, përmes zbatimit të disa iniciativave për zhvillimin e komunitetit, fokusin kryesor e pati mbështetjen e klubeve sportive lokale. Një total prej 126 individësh, pjesë e klubeve sportive të mbështetura, përfituan nga sponsorizimet, të cilat përfshinin katër klube të dedikuara futbollit, karatesë dhe mundjes. Kjo bashkëpunim nënvizon angazhimin e vazhdueshëm të SHARRCEM për të promovuar mirëqenien sociale dhe për të nxitur angazhimin e të rinjve përmes sportit.

Struktura e qeverisjes dhe angazhimi në përgjegjësitë shoqërore

Në SHARRCEM, qeverisja efektive është thelbësore për arritjen e objektivave tona strategjike dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë. Ne operojmë nën një strukturë qeverisëse me një nivel, e cila i mundëson Bordit të Menaxhimit të marrë vendime të shpejta dhe të informuara që çojnë biznesin tonë përpara. Për të mbështetur këtë strukturë, ne kemi krijuar disa borde dhe komitete përgjegjëse për mbikëqyrjen e fushave kyçe operacionale. Korniza jonë e

qeverisjes për Përgjegjësitë Shoqërore të Korporatës (CSR) është veçanërisht e rëndësishme, duke siguruar që kujdesi për mjedisin, ndikimi social dhe angazhimi i palëve të interesuara të mbeten në qendër të vendimarrjes sonë.

Bordi i CSR-së luan një rol jetik në ruajtjen e dialogut aktiv me punonjësit dhe palët e interesuara, duke ndihmuar në përafrimin e nismave tona me vlerat dhe pritjet e përbashkëta. Ky qasje nxit transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha fushat e operacioneve tona.

Struktura e Menaxhimit:



ANËTARËSIMET

Si pjesë e përkushtimit tonë të vazhdueshëm për të vepruar me përgjegjësi në biznes dhe për zhvillim të qëndrueshëm, SHARRCEM merr pjesë aktive në shoqata kyçe të biznesit kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Këshillin e Investitorëve Evropianë dhe Rrjetin të Përgjegjësisë Shoqërore Korporative në Kosovë (CSR Network).

EIC – Këshilli i Investitorëve Evropianë

Këshilli i Investitorëve Evropianë (EIC) është një shoqatë jofi timprurëse, e themeluar nga investitorë nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet e EFTA-s. EIC është një shoqatë unike biznesi që bashkon investitorët evropianë nga vendet e BE-së dhe EFTA-s nën një mision të përbashkët – për të përmirësuar klimën e investimeve në Kosovë duke avokuar për legjislacion më të mirë dhe praktika më të mira biznesi në nivel teknik. Ajo synon të identifi kojë dhe adresojë barrierat kryesore me të cilat përballen investitorët evropianë në Kosovë. EIC u krijua me qëllim të lehtësimit të iniciativave investuese në Kosovë dhe kontributit të përgjegjshëm për krijimin e një mjedisi biznesi efi kas. Sharrcem krenohet me kontributin e saj të rëndësishëm në EIC, në përputhje me përkushtimin tonë për të ndihmuar në zhvillimin e një Kosove të qëndrueshme dhe rezistente.

Në maj 2024, EIC organizoi Forumin e Parë për Investime të Qëndrueshme: “Navigimi në Rugën drejt një të Ardhmeje më të Gjelbër”. Ky event mbledhi liderë nga sektorë të ndryshëm për të eksploruar strategjitë që nxisin investimet e qëndrueshme dhe ndryshimin transformues. Si pjesë e programit, Drejtori ynë për Kosovë, z. Behar Disha, mori pjesë në panelin e diskutimit me temë “Investimet e Qëndrueshme – Dialogu dhe Zbatimi i Marrëveshjes së Gjelbër”. Diskutimi theksoi rolin thelbësor të politikave, bashkëpunimit ndërsektorial dhe inovacionit në avancimin e fi nancave të qëndrueshme dhe realizimin e objektivave të Marrëveshjes së Gjelbër.



Rrjeti i Përgjegjësisë Shoqërore Korporative në Kosovë (CSR Network)

SHARRCEM vazhdon të luajë një rol udhëheqës në avancimin e përgjegjësisë shoqërore të biznesit në Kosovë përmes bashkë-themelimit dhe drejtimit aktiv në Rrjetin për Përgjegjësi Shoqërore Korporative në Kosovë. Ky rrjet shërben si një platformë bashkëpunimi për kompani dhe organizata të përkushtuara ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, veprimit të përgjegjshëm në biznes dhe ndikimit pozitiv shoqëror. Në vitin 2024, Rrjeti intensifi koi përpjekjet e tij për të promovuar vetëdijen dhe veprimin e përbashkët mbi sfi da kyçe të qëndrueshmërisë, përfshirë të drejtat e njeriut, praktikatat e punës, përgjegjësinë mjedisore, luftën kundër korrupsionit dhe çështje të tjera shoqërore.

Ndër momentet kryesore të vitit, përfaqësuesi i SHARRCEM-it, z. Vigan Sylejmani, në rolin e Nënkrëtarit të Bordit, mori pjesë në Mbledhjet Vjetore të CSR Europe 2024 në Bruksel. Organizuar në kuadër të Samitit Evropian për Industrinë e Qëndrueshme, ky event mbledhi mbi 200 pjesëmarrës dhe 40 folës në nivel drejtuesish të lartë nga e gjithë Evropa, për të adresuar peizazhin në zhvillim të rregulloreve të BE-së mbi qëndrueshmërinë dhe për të ndarë praktikatat më të mira për të formësuar të ardhmen e biznesit të përgjegjshëm në Evropë. Pjesëmarrja aktive e SHARRCEM-it refl ekton përkushtimin tonë të vazhdueshëm për të kontribuar në dialogun politik dhe për të nxitur transformimin e qëndrueshëm si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë evropian.

Në vitin 2024, si Nënkrëtar i Bordit, z. Sylejmani shërbeu gjithashtu si anëtar i panelit ekspert për vlerësimin dhe përzgjedhjen e bizneseve fi tuese për Çmimet CSR 2024. Për më tepër, SHARRCEM mbështeti ceremoninë e Çmimeve CSR, e cila u organizua nën patronazhin e CSR Europe në tetor 2024.



RISHIKIMI I

PERFORMANCËS FINANCIARE

Qarkullimi	€	108,612,163
Totali i asetëve	€	49,078,643
EBITDA	€	38,061,311
Fitimi (humbja) pas taksave	€	27,876,640
Shpenzimet Kapitale	€	8,085,810
Investimet në mjedis dhe shëndetin&sigurinë në punë	€	461,703

Deklaratat e performancës në për ESG

Qasja e TITANIT për raportimin e performancës në fushën ESG, dhe e përdorur nga Sharrcem SH.P.K. në këtë Raport

Qasja e Sharrcem SH.P.K. për raportimin e Performancës ESG është në përputhje me zotimet vullnetare të TITANIT ndaj parimeve IIRC, Dhjetë Parimeve të UNGC-së, Kartës dhe Udhëzimeve të GCCA, dhe rekomandimeve të TCFD-së, dhe ofron një lidhje me Kornizën e Bordit të Standardeve të Qëndrueshmërisë në Kontabilitetit (SASB).

Ndryshimet në strukturën dhe përmbajtjen e Raportit Vjetor të Integruar 2022 (IAR), Deklaratat për ESG.

Treguesit e ri kryesor të performancës (KPI) dhe shpalosje të tjera në secilën fushë të fokusit:

- Zhvillimi – Mundësitë në Punë: KPI-të për programet e pushimit prindëror dhe punonjësve me aftësi të kufizuara në Tabelën 2.2.
- Ndikimi pozitiv në mjedisin lokal: Përdorimi në total i tokës lidhur me rehabilitimin e guroreve në Tabelën 2.3.
- Burime të përgjegjshme: Konsumi dhe prodhimi i energjisë për sasinë totale të energjisë së konsumuar brenda, % e energjisë elektrike të konsumuar. Menaxhimi i mbetjeve si % për llojin e trajtimit (të kompostuara, të ricikluara ose të depozituara në deponi). Shih Tabelën 2.4.
- Qeverisja e mirë, transparencja dhe etika në biznes: për orët e trajnimit në temën kundër rryshfetit dhe korrupsionit (Tabela 2.5.1), të hyrat nga produktet që lidhen me qëndrueshmërinë dhe % e shitjeve neto nga produktet e lidhura me qëndrueshmërinë në Tabelën 2.5.2. Në shtuam tabelën 2.5.10 “Treguesit e krijimit të vlerës” dhe prezantuar Tabelën e re 2.5.11 “Lidhja e shpalosjeve tona me TITAN COP sipas platformës së përmirësuar të UNGC-së”. COP-ja jonë është një raport i pavarur dhe i disponueshëm publikisht sipas platformës UNGC (referencat dhe lidhjet me faqen e internetit në Tabelën 2.5.11).

Përdorimi i kursit të këmbimit ‘mesatar vjetor’ për të gjitha filialet e TITANIT, monedha e

Sharrcem SH.P.K në vitin 2022 ishte në përputhje me politikën kontabël të TITANIT për përkthimin e valutës së huaj, në veçanti për të ardhurat dhe shpenzimet për pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat gjithëpërfshirëse.

Shih shënimet më poshtë për lehtësimin rishikimin e pasqyrave të performancës ESG (në lidhje me KPI-të në Tabelat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5.1).

Garancia: KPI-të specifike të përfshira në fushën e angazhimit të garancisë nga Auditorët e Pavarur të Palëve të Treta.

GCCA: KPI-të specifike të përlogaritura sipas angazhimeve sektoriale të integruara nga TITAN, duke zbatuar Kartën dhe Udhëzimet Kornizë të GCCA-së. Shih Tabelën 2.5.9.

UNGC: TITAN zbaton kërkesat e raportimit për përmbushjen e kriterëve të Paktit Global të OKB-së në lidhje me nivelin e avancuar të Komunikimit të Progresit (COP) sipas platformës dhe Udhëzimeve të Përmirësuar që janë publikuar nga UNGC në 2022. BU mbulohet nga COP i kompanisë mëmë të TITAN Group (TITAN Cement International). Shih Tabelën 2.5.11.

UNCTAD: TITAN kapërdorur në kuadër të raportimit të vet, KPI-të e zbatueshme sipas Udhëzimit mbi Treguesit Bazë për Qëndrueshmërinë dhe Raportimin e Ndikimit të SDG-së (publikimi i fundit 2022).

TCFD: TITAN raporton sipas rekomandimeve të Task Forcës për Shpalosjet Financiare lidhur me Klimën (TCFD).

SASB: TITAN vepron sipas kërkesave të Bordit të Standardeve të Qëndrueshme në Kontabilitetit (SASB), i cili u bashkua me Këshillin Ndërkombëtar të Raportimit të Integruar (IIRC) në 2021 për të formuar Fondacionin e Raportimit të Vlerave (VRF). Në vitin 2022, VRF u konsolidua nën Fondacionin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) për të mbështetur punën e Bordit i Standardeve Ndërkombëtare të Qëndrueshmërisë (ISSB).

Udhëzime për KPI-të dhe shpalosje të tjera

Tabela 2.5.9 “Standardet e sektorit dhe të tjera për shpalosjet jo-financiare në vitin 2022” jep referenca të detajuara për dokumentet udhëzuese për sektorin (GCCA) dhe institucionet tjera globale (UNCTAD dhe UNGC), të cilat janë përfshirë në qasjen raportuese të TITANIT. Lidhjet e KPI-ve janë të ilustruara nën deklaratat e performancës ESG për të gjitha fushat e fokusit të Dekarbonizimit dhe Digjitalizimit (shih Tabelën 2.1), Zhvillimi – mundësi në punës (Tabela 2.2), Fusha e fokusit e ndikimit pozitiv në mjedisin lokal (Tabela 2.3), Burimet e përgjegjshme (Tabela 2.4), dhe Qeverisja e mirë, transparencja dhe etika në biznes (Tabela 2.5.1 dhe 2.5.10), posaçërisht për udhëzimet e raportimit sipas UNGC COP. Shih Tabelën 2.5.11.”

Deklaratat e performancës për ESG - Tabelat

1. Çështjet Materiale

	Grupi TITAN	Kosovë
1.	Model biznesi i gatshëm në të ardhmen për një botë neutrale ndaj karbonit	Mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm i punës për punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit përgjatë zinxhirit të vlerës
2.	Mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm në punë	Performanca mjedisore
3.	Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika në biznes	Angazhimi dhe kontributi për komunitetet tona lokale
4.	Vend pune i larmishëm dhe gjithëpërfshirës	Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika në biznes
5.	Ndikim pozitiv në shoqërinë, ekonominë dhe mjedisin lokal	Angazhimi dhe zhvillimi i punonjësve
6.	Inovacion me theks në digjitalizim dhe dekarbonizim	Ndryshimet klimatike dhe efienca në energji
7.	Zhvillimi i vazhdueshëm i punonjësve tanë	Vend pune i larmishëm dhe gjithëpërfshirës
8.	Zinxhiri i furnizimit i besueshëm dhe i qëndrueshëm	Zinxhir i përgjegjshëm, i besueshëm dhe i qëndrueshëm i furnizimit
9.	Efikasiteti i burimeve, riciklimi dhe rigjenerimi, kontributi në ekonominë qarkore	Model biznesi i gatshëm për të ardhmen për një botë me karbon neutral

	Çështje materiale shtesë për palët e interesit bazuar në validimin e fundit të materialitetit në 2022	
		Kosovë
1.		•Mirëqenia e Klientit •Privatësia e Klientit •Siguria e të Dhënave •Qasja dhe Përballueshmëria •Dizajni i Produktit dhe Menaxhimi i Ciklit Jetësor

Niveli i Çështjeve Materiale:

2. Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI) në ESG

2.1 Fusha në fokus: Dekarbonizimi dhe Digjitalizimi

Kodi	Treguesit e Performancës për ESG	Njësia	2024	2023	2022	2021	2020	GCCA	UNGC	GRI	UNCTAD	TCFD	SASB	OZhQ-të dhe Objektivat
2.1.1 Çështja Materiale: Model biznesi i gatshëm në të ardhmen për një botë neutrale ndaj karbonit														
Aktivitetet për prodhimin e çimentos														
1.1	Niveli 1 emetimi ² bruto i CO ₂	million t	0.40	0.37	0.35	0.3	0.3	●	●	305-1	●	●	EM-CM-110a.1	OZhQ 9.4
1.2	Niveli 1 emetimi specifik bruto i CO ₂	kg/t produkti çimentos	565.3	566.9	1	1	1	●	●	305-4		●		
1.3	Niveli 1 shkalla e mbulimit të emetimit bruto të CO ₂	% e prodhimit të klinkerit	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0			305-1				
1.4	Niveli 1 emetimi bruto i CO ₂ mbulohet nga rregulloret kufizuese	%	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		●		●			
1.5	Niveli 1 emetimi neto i CO ₂	million t	0.40	0.37	0.35	0.3	0.3	●	●		●	●		
1.6	Niveli 1 emetimi specifik neto i CO ₂	kg/t produkti çimentos	565.3	566.8	597.9	578.2	596.7	●	●	305-4		●		
1.7	Niveli 1 shkalla e mbulimit të emetimit neto të CO ₂	% e prodhimit të klinkerit	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0			305-1				
1.8	Niveli 2 emetimi ³ i CO ₂	million t	0.06	0.05	0.07	0.1	0.1	●	●		●	●		
1.9	Niveli 2 emetimi specifik i CO ₂	% e prodhimit të klinkerit	92.1	79.0	125.3	129.3	125.7	●	●			●		
1.10	Niveli 2 shkalla e mbulimit të emetimit të CO ₂	kg/t produkti çimentos	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0							
1.11	Niveli 2 emetimi ^{4,*} i CO ₂	% e prodhimit të klinkerit	59.5	48.4	59.8	52.6	37.2	●				●		
1.12	Kategoria 1 - Mallrat dhe shërbimet e blera ⁹	kt	7.6	9.8	6.6	14.1	6.5	●				●		
1.13	Kategoria 3 - Aktivitete të lidhura me karburantin dhe energjinë	kt	30.0	24.8	36.1	25.0	16.1	●				●		
1.14	Kategoria 4 - Transportimi dhe shpërndarja për furnizim	kt	11.6	7.0	8.8	6.4	5.5	●				●		
1.15	Kategoria 6 - Udhëzimi Zyrtar	kt	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●				●		
1.16	Kategoria 7 - Udhëtimi i punonjësve	kt	0.2	0.0	0.2	0.1	0.1	●				●		
1.17	Kategoria 9 - Transportimi dhe shpërndarja për shpërndarje	kt	10.1	6.8	8.1	7.1	9.0	●				●		

Kodi	Treguesit e Performancës për ESG	Njësia	2024	2023	2022	2021	2020	GCCA	UNGC	GRI	UNCTAD	TCFD	SASB	OZhQ-të dhe Objektivat
1.18	Niveli 3 emetimi ⁸ specifik i CO ₂	kg/t produkti çimentos	84.4	74.7	102.3	95.5	67.0	●		305-4		●		
1.19	Niveli 3 shkalla e mbulimit të emetimit të CO ₂	% e prodhimit të klinkerit	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0			305-3				
1.20	Shkalla e zëvendësimit të lëndëve djegëse	% Nxehtësia	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	●	●	302-3	●	●		
1.21	Shkalla e zëvendësimit të lëndëve djegëse alternative	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●	EM-CM-130a.1	
1.22	Biomasa në përzierjen e karburantit ⁵	% Nxehtësia	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	●	●		●	●	EM-CM-130a.1	
1.23	Përzierja e lëndës djegëse, konsumimi i energjisë për prodhimin e klinkerit dhe çimentos	% Nxehtësia	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0		●			●		OZhQ 7.2
1.24	Lëndët djegëse fosile konvencionale	% Nxehtësia	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0		●			●		OZhQ 12.2
1.25	Thëngjilli, antraciti, dhe mbetjet e thëngjillit	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		●			●		OZhQ 13.1
1.26	Koksi i naftës	% Nxehtësia	99.2	98.4	98.0	97.9	96.8		●			●		
1.27	Linjiti	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		●			●		
1.28	Lëndë djegëse të tjera të ngurta fosile	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		●			●		
1.29	Gazi natyror	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		●			●		
1.30	Lëndë djegëse të rënda (ultra)	% Nxehtësia	0.8	1.6	1.9	2.0	3.2		●			●		
1.31	Vaj motorik	% Nxehtësia	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1		●			●		
1.32	Benzinë, LPG (gaz i lëngshëm apo propan)	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		●			●		
1.33	Lëndë fosile dhe lëndë djegëse alternative	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.34	Goma	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.35	RDF	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.36	Tallash i lagësht	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.37	Mbetjet industriale të përziera	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.38	Mbetje tjera me bazë fosile dhe të përziera (të ngurta)	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.39	Lëndë djegëse të biomasës	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		

Kodi	Treguesit e Performancës për ESG	Njësia	2024	2023	2022	2021	2020	GCCA	UNGC	GRI	UNCTAD	TCFD	SASB	OZHQ-të dhe Objektivat
1.40	Mbetje e thatë nga kanali i ujërave të zeza	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.41	Dru, tallash jo i lagësht	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●	302-3	●	●		
1.42	Mbetje bujqësore, organike, pelena, thëngjill druri	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.43	Të tjera	% Nxehtësia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●	●		
1.44	Konsumi i lëndëve djegëse alternative (totali)	t	0	0	0	0	0	●	●	302	●	●	EM-CM-130a.1	
1.45	Produkte ⁶ me përmbajtje mesatare të karbonit	%	66.2	66.8	67.5	67.5	68.3	●	●			●		
1.46	Moderate carbon products ⁶	% prodhimi i çimentos	100.0	100.0	100.0	99.0	98.2					●		
1.47	Produkte të gjelbra (me karbon të ulët) ^{1,7}	% prodhimi i çimentos	12.5	16.7	9.4	2.9	3.4					●		

Shënime

Shënime për KPI-të specifike

1. Treguesi i ri. Mund të gjeni më shumë detaje në pjesën ""Qasja e TITAN-it për raportimin e performancës për ESG"".
2. Emetimet e drejtpërdrejta të CO₂ në lidhje me funksionimin e objekteve të TITAN-it për prodhimin e klinkerit, çimentos dhe produkteve të çimentos.
3. Emetimet indirekte të CO₂ të lidhura me emetimet e liruara për prodhimin e energjisë elektrike të konsumuar në objektet e TITAN-it për prodhimin e klinkerit, çimentos dhe produkteve të çimentos. Për llogaritjen e tyre, ne përdorim faktorët e emetimit të siguruar nga furnizuesi i energjisë elektrike (bazuar në treg) ose burime të tjera të dhënash në dispozicion për publikun.
4. Emetimet indirekte të CO₂ të lidhura me emetimet e zinxhirit të furnizimit.
- 5.% e energjisë që krijohet nga biomasa në konsumin total të energjisë termike.
6. Produktet me përmbajtje mesatare të karbonit i referohen llojeve të çimentos të prodhuara dhe të cilat emetojnë karbon të paktën 10.0% më pak në krahasim me llojin tipit të OPC-së dhe të çdo produkti të çimentos që shitet për t'u përdorur si çimento ose aditivë betoni.
7. Produktet e gjelbra (me përmbajtje të ulët karboni) i referohen llojeve të çimentos të prodhuara dhe të cilat emetojnë karbon të paktën 25.0% më pak në krahasim me llojin tipit të OPC-së dhe të çdo produkti të çimentos që shitet për t'u përdorur si çimento ose aditivë betoni.
8. Analiza e Nivelit 3 mbulon 6 nga 15 kategoritë, përkatësisht mallrat dhe shërbimet e blera, aktivitete të lidhura me karburantin dhe energjinë, transportin dhe shpërndarjen për furnizim, udhëtimet zyrtare, udhëtimet e punonjësve dhe transportin dhe shpërndarjen për shpërndaje, që konsiderohen të rëndësishme për aktivitetet e çimentos sipas analizës së GCCA-së.
9. Emetimet në Nivelin 3 të Kategorisë 1 nuk përfshijnë emetimet që lidhen me shërbimet si shërbimet e të dhënave, shërbimet profesionale, shërbimet e mirëmbajtjes, shërbimet e ushqimit, shërbimet e sigurisë, shërbimet e pastrimit, etj. pasi nuk konsiderohet se kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në emetimet e përgjithshme në Nivelin 3, ndërkohë që informacionet e besueshme relevante nuk janë lehtësisht në dispozicion.

Lidhja e KPI-ve me Standardet SASB

Lidhja e treguesve të performancës ESG me metrikat sipas Standardeve SASB, konkretisht:

- EM-CM-110a.1 në fushën "Emetimet e Gazeve Serë" për emetimet bruto globale të nivelit 1, përqindja e mbuluar nga rregulloret për kufizimin e emetimeve.
- EM-CM-130a.1 në fushën "Menaxhimi i Energjisë" për energjinë totale të konsumuar, përqindjen e energjisë elektrike të rrjetit, përqindjen e energjisë alternative dhe përqindja e burimeve të rinovueshme."

2.2 Fusha në fokus: Zhvillimi – Mundësitë në Punë

Kodi	Treguesit e Performancës për ESG	Njësia	2024	2023	2022	2021	2020	GCCA	UNGC	GRI	UNCTAD	TCFD	SASB	OZhQ-të dhe Objektivat
2.2.1 Çështja materiale: Mjedisi i sigurt dhe i shëndetshëm në punë														
Të gjitha aktivitetet														
2.1	Fatalitete në punonjës	#	0	0	0	0	0	●	●	403-9	●			OZhQ 3.6
2.2	Shkalla e fatalitetit në punonjës	#/10 ⁴ persona	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●			OZhQ 3.8
2.3	Fatalitete tek kontraktuesit	#	0	0	0	0	1	●	●		●			OZhQ 4.3
2.4	Fatalitete në palë të treta	#	0	0	0	0	0	●	●		●			OZhQ 8.8
2.5	Lëndime të punonjësve me kohë të humbur në punë (LTIs)	#	0	0	2	0	1	●	●		●			
2.6	Shkalla e Shpeshtësisë e Kohës së Humbur në Punë nga punonjësit si rezultat i lëndimit (LTIFR)	#/10 ⁶ orë	0.0	0.0	4.2	0.0	2.1	●	●		●		EM-CM-320a.1	
2.7	Ditët e humbura në punë nga punonjësit ⁴	d	0	0	22	0	29	●	●					
2.8	Shkalla e seriozitetit të lëndimit të punonjësve me kohë të humbur në punë ⁴	d/10 ⁶ orë	0.0	0.0	46.4	0.0	59.6	●	●		●			
2.9	Lëndime të Kontraktuesit me kohë të humbur në punë (LTIs)	#	0	0	1	0	1	●	●		●			
2.10	Shkalla e Shpeshtësisë e Kohës së Humbur në Punë nga Kontraktuesit si rezultat i lëndimit (LTIFR)	#/10 ⁶ orë	0.0	0.0	2.8	0.0	3.1	●	●		●		EM-CM-320a.1	
Të gjitha aktivitetet														
2.11	Ngjarje me mundësi lëndimi (Near misses)	#	47	40	36	36	14		●				EM-CM-320a.1	OZhQ 3.6
2.12	Orët e trajnimit për shëndet dhe siguri për kontraktuesit ⁵	orë/person	25.3	16.7	15.1	22.2			●	403-5	●			OZhQ 3.8
2.13	Orët e trajnimit për shëndet dhe siguri për kontraktuesit ⁵	orë/person	14.9	21.1	18.8	6.9	5.8		●		●			OZhQ 4.3
2.14	Shpenzimet për Shëndetin dhe Sigurinë ²	€	564,919	778,829	669,673	524,537	332,556		●	201-2	●			OZhQ 8.8
Aktivitetet për Prodhimin e Çimentos														
2.15	Fatalitete në punonjës	#	0	0	8.1	0	0	●	●	403-9	●			OZhQ 3.6
2.16	Shkalla e fatalitetit në punonjës	#/10 ⁴ persona	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	●	●		●			OZhQ 3.8
2.17	Fatalitete tek kontraktuesit	#	0	0	0	0	1	●	●		●			OZhQ 4.3

Kodi	Treguesit e Performancës për ESG	Njësia	2024	2023	2022	2021	2020	GCCA	UNGC	GRI	UNCTAD	TCFD	SASB	OZhQ-të dhe Objektivat
Aktivitetet për Prodhimin e Çimentos														
2.18	Fatalitete në palë të treta	#	0	0	0	-	0	●	●		●			OZhQ 8.8
2.19	Lëndime të punonjësve me kohë të humbur në punë (LTIs)	#	0	0	2	0	1	●	●		●			
2.20	Shkalla e Shpeshhtësisë e Kohës së Humbur në Punë nga punonjësit si rezultat i lëndimit (LTIFR)	#/10 ⁶ orë	0.0	0.0	4.2	0.0	2.1	●	●		●		EM-CM-320a.1	
2.21	Ditët e humbura në punë nga punonjësit	d	0	0	22	0	29	●	●					
2.22	Shkalla e seriozitetit të lëndimit të punonjësve me kohë të humbur në punë	d/10 ⁶ orë	0.0	0.0	46.4	0.0	59.6	●	●		●			
2.23	Lëndime të Kontraktuesit me kohë të humbur në punë (LTIs)	#	0	0	1	0	1	●	●		●			
2.24	Iniciativat për mirëqenien e punonjësve ^{1,2}	#	13	13	17	9	7							

2.2.2 Çështja materiale: Vend pune i larmishëm dhe gjithëpërfshirës

2.25	Punësimi mesatar ⁶	#	229	243	242	237	241		●	2-7b				OZhQ 5.4
2.26	Numri i punonjësve në fund të vitit,	#	235	244	246	236	239		●					OZhQ 8.5

Qarkullimi mesatar i punonjësve sipas gjinisë OZhQ 8.6

2.27	Femra	#	23.0	0.0	0.0	0.0	0.0			401-1				OZhQ 8.8
2.28	Meshkuj	#	212.0	1.8	4.8	2.2	1.8							OZhQ 10.3

Qarkullimi i punonjësve sipas moshës 2,7

2.29	Nën 30 vjeç ²	%	1.0	0.0	7.0	0.0	0.0			401-1				
2.30	Mes moshës 30-50 ²	%	4.0	0.0	2.4	0.0	1.1							
2.31	Mbi moshën 50 ²	%	15.0	2.6	5.3	3.4	2.1							
2.32	Punonjësit që janë larguar ⁷	#	25	4	11	5	4		●					

Punonjësit që janë larguar sipas moshës

2.33	Nën moshën 30	#	1	0	1	0	0			401-1				
2.34	Mes moshës 30-50	#	3	0	2	0	1							

Kodi	Treguesit e Performancës për ESG	Njësia	2024	2023	2022	2021	2020	GCCA	UNGC	GRI	UNCTAD	TCFD	SASB	OZhQ-të dhe Objektivat
Punonjësit që janë larguar sipas moshës														
2.35	Mbi moshën 50	#	21	4	8	5	3							
Punonjësit që janë larguar sipas gjinisë														
2.36	Femra	#	1	0	0	0	0			403-9				
2.37	Meshkuj	#	24	4	11	5	4							
2.38	Punonjës të rinj të punësuar, mesatarisht. ⁷	%	6.4	0.8	8.1	0.8	0.0		●					
2.39	Punonjës të rinj të punësuar ⁷	#	15	2	20	2	0		●					
Punonjës të rinj të punësuar sipas gjinisë ⁷														
2.40	Femra	#	7	0	5	1	0		●	403-9				
2.41	Meshkuj	#	8	2	15	1	0		●					
Punësimet e reja sipas moshës ⁷														
2.42	Nën moshën 30	#	10	2	10	2	0		●	401-1				
2.43	Mes moshës 30-50	#	5	0	7	0	0		●					
2.44	Mbi moshën 50	#	0	0	3	0	0		●					
Punësimi sipas llojit ⁷														
2.45	Orari i plotë	#	15	2	20	2	0		●	2-7.				
2.46	Gjysmë orar	#	0	0	0	0	0		●					
2.47	E përkohshme	#	0	0	0	0	0		●					
Punësimi sipas kategorisë ⁷														
2.48	Menaxherë të lartë	#	2	2	1	2	2		●	2-7.				
2.49	Menaxherë	#	17	16	17	16	16		●					
2.50	Administratë/teknikë	#	64	63	63	55	54		●					

Kodi	Treguesit e Performancës për ESG	Njësia	2024	2023	2022	2021	2020	GCCA	UNGC	GRI	UNCTAD	TCFD	SASB	OZhQ-të dhe Objektivat
Punësimi sipas kategorisë ⁷														
2.51	Punonjës gjysmë të kualifikuar/pakualifikuar	#	152	163	166	163	167		●					
Punësimi sipas moshës														
2.52	Nën moshën 30	#	16	8	13	5	7			2-7.				
2.53	Mes moshës 30-50	#	76	80	83	82	87							
2.54	Mbi moshën 50	#	143	156	150	149	145							
Punësimi sipas gjinisë ⁷														
2.55	Femra	#	23	17	17	12	11		●	2-7.				
